

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The **Albanian**

VITI I 21 I BOTIMIT 25 QERSHOR 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

PLANI I LONDRËS PËR MIGRANTËT, A RREZIKON BALLKANI TË BËHET 'DEPO' E TYRE?



PETRIT KUÇANA

**PËRSE TË MOS KETË
NJË 'PAKETË
BREGDETI '
PËR DIASPORËN?**



ARBEN MANAJ

**KEIR STARMER
PRANON DESHTIMIN
NE LUFTEN NDAJ
GOMONEVE!**

**BOMBA
BËRTHAMORE
E SHQIPËRISË!**

LUTFI DERVISHI



**BRITANIA DHE ÇËSHITJA
SHQIPTARE GJATË RËNIES
SË PERANDORISË OSMANE**

ROBERT C. AUSTIN



**FYTYRA E HUAJ
E NJË 'SHTËPIE'**

SONILA MEÇO



**SPAÇ 1973
- MARTIRËT E LIRISË',
REBELIMI KULTUROR VEPR
KUNDËR HARRESËS**

MUJË BUÇPAPAJ



**SHQIPTARËT NË
REVOLUCIONIN TRUMP**

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Vazhdojnë të mbeten të munguara 'Ditët e Diasporës' në Shqipëri. As që e ka vënë kush 'ujin në zjarr' për një qasje ndryshe ndaj diasporës, si një traditë që ekziston në shumë vende, duke filluar me

PËRSE TË MOS KETË NJË PAKETË BREGDETI PËR DIASPORËN?

Kosovën.

Duket se diaspora në Shqipëri vazhdon të konsiderohet në mos si 'mërgata e qyqeve', shpikje tipike e kohës së largqoftit, si bankë që sjell miliarda dhe këtu fillon dhe mbaron 'misioni i saj'.

U shpresua që pas 'fjalimeve shëtitëse' nëpër diasporë, kryeministri do të ndikojë nga takimet e drejtpërdrejta qoftë edhe me mbështetësit e tij, dhe do të kishte një qasje ndryshe. Po rezultojnë si një ripërsëritje e të ashtuquajturve 'samite të diasporës' që u tretën ashtu si pa u vërejtur, bashkë me ngrehinën e përcudnuar të quajtur 'Ministri e shtetit për Diasporën'. Sot kushedi rrallëkush mund të kujtohet për një 'bëmë' të ish-ministrit që mbeti edhe jashtë parlamentit.

Po pse e gjithë kjo shpërfillje ndaj diasporës?

Në kushtet kur diaspora konsiderohet si mbajtëse e 'paqes sociale', që 'mban' mijëra e mijëra familje që nuk mund të plotësojnë minimumin jetik, (fakte këto të gjithëpranuar) askush nuk arrin të zbërthejë 'përse-në' e shpërfilljes.

Deri më sot nuk kemi parë ndonjë iniciativë konkrete për diasporën, ndonëse përmendet 'paketa e maleve' që ngjan më tepër me një thëllim shpërfillje sesa projekt të mirëfilltë.

Nëse dikush dëshiron të investojë në male, qoftë edhe duke e kthyer shtëpinë e gjyshit në bujtinë, nuk paguaka taksa. Kush e ka patur ndërmend e ka bërë tashmë, pa prituri për asnjë paketë apo yshtje thujse boshe.

Po përse të mos ketë paketë bregdeti për diasporën?

Si është e mundur që asnjë nga diaspora nuk doli të jetë investitor strategjik në bregdetin shqiptar? Investitorët e Diasporës e kanë patur të pamundur të sfidonin ata investitorët strategjikë të përzgjedhur nga qeveria shqiptare dhe që mbeten në mbamendjen e publikut si Gjoka i Velipojës që vazhdon të jetë në burg, drejtorët e 5D, edhe këta të burgosur, apo burri i ministres Xhaçka (për të cilët u burgos një kryebashkiak) që nuk mund të lejonin "ata nga mali te ngulnin çadrat në bregdet".

Duket se mbetet e pamundur që për diasporën të ketë ndonjë shans për

ndonjë 'paketë bregdeti'. Diaspora u dashkërka të mjaftohet me paketën e maleve. Paketat e tjera i ditkërka qeveria?!...

Çfarë do të ndodhte që qeveria të hapej drejt diasporës që të shfrytëzonte potencialin e jashtëzakonshëm të saj?

Përse të mos ketë qoftë edhe mundësi për eksperiencë punë në institucionet e shtetit shqiptar, siç e bën Kosova?...

Gjithçka do të ishte më e thjeshtë nëse do të kishte paketa të gjithanshme për diasporën, për të rienergjuar gjithçkanë që lidhet me diasporën. Prej saj do të fitonin të gjithë. Edhe qeveria...

SONILA MEÇO

Kur u mblodhëm vonë në shtëpi pas një dite të gjatë nëpër zagushi, askush nuk kish fuqi e nerv për një darkë të shëndetshme.

"Pica?", thamë thujse njëkohshëm. E nuk kaluan 20 minuta kur në celular një zë i ndrojtur më fliste me një shqipe të çalë:

"Erda jam te ardeza juaj"

Dal të marr porosinë dhe shoh një djalë zeshkan, që më zgjat picat dhe buzëqesh me një "faleminderit" të ngatërruar bashkëtingëlloresh, kotkat e së cilës i "gëlltiste" me uljen e zërit. E pyes se nga është e më thotë nga India.

Heu!!!

E treta herë këtë javë. Të hënën, në mëngjes tek servisi teksa hyra të ndërroj gomën e makinës, 5 djem indianë më shërbyen me kujdes, shpejtësi e pa fjalë. Sot në drekë tek dyqani ku bëjnë ca bukë të mira thekre nga një çift shqiptarësh më shërbeu një indian, që zëvendësonte shokun tjetër indian, që kish ikur pa lajmëruar as agjensinë që i kish sjellë në Tiranë.

Në lagjen tonë karrocet e fëmijëve shpesh i shëtisin filipinaset. Në ndërtime, dy lagje më tutje gjen ca djem bangladeshas, që bëjnë punë hamalli. Dhe vetëm një "bye friend" nga indiani i qetë, i paqetë, i butë më riktheu në derën e shtëpisë në qytetin ku kam lindur, jam rritur e jam bërë nënë. E për herë të parë shtëpia më ngjau si një ishull i vogël në një det të panjohur, ku muret flasin gjuhën e kujtimeve të mia, por qyteti përreth flet një gjuhë tjetër, të ftohtë, të importuar,

që s'ka as rrënjë, as mall, as histori.

Dhe nis e më trishton jo prania e të tjerëve, por mungesa e tanëve.

Unë nuk jam raciste.

Kjo nuk është ksenofobia.

Është trishtim për Tiranën që nuk po rritet, por Tiranën, që po zëvendësohet.

Po zhduken zërat, lagjet, buzëqeshjet e njohura. Po mbetet veç kaosi dhe qiraja e shtrenjtë.

Kur flas me ndonjë mik, që më kujton se edhe shqiptarët janë prituri jashtë, ndaj duhet të mirëpresim emigrantët që vijnë tek ne kam gjithnjë bindjen dhe kurajon ta pranohet se është një krahasim i rremë dhe shpesh hipokrit.

Sepse shqiptarët, kur ikën në vitet '90 dhe me eksode të tjera më pas, nuk shkuan për të zëvendësuar qytetarët vendas, apo për të mbushur boshllëqet e një sistemi të kalbur.

Ata u përplasën me mure racizmi, me punë të rënda, me vite të tëra pa dokumente dhe u përshtatën ngadalë nëpër shoqëri që funksiononin. U integruan përmes ligjit, shkollës, gjuhës dhe sakrificës personale. Nuk u përqaftuan si zgjidhje për zbrazjen e vendeve ku emigruan, por u toleruan si sfidë.

Ndërsa Shqipëria nuk po i trajton sot emigrantët si sfidë për t'u menaxhuar denjësisht, por si zëvendësues me kosto të ulët për një brez që ka ikur. Nuk po ndërton një sistem bashkëjetese, por një (anti)model ku shqiptari largohet për pagë të denjë, ndërsa

të huajit i jepet pagë minimale për të mos folur, për të mos protestuar dhe për të mos kërkuar më shumë.

Prandaj nuk është e njëjta gjë. Shqipëria sot nuk po ndihmon të tjerët, por po zëvendëson vetveten. Dhe kjo është dramatikë.

Kur ndonjë i njohur, i rehatuar me punë shteti më thotë se ky është zhvillim, i kërkoj të shohë në sy fëmijët e vet e ta pohojë para tyre. "Nuk janë këtu", më thotë. "Nuk edukohen këtu". E sërish pa e fyer për hipokrizinë i kujtoj se zhvillimi është kur njerëzit që e ndërtuan këtë qytet jetojnë më mirë. Kjo jona është zbrazje. Është ndërrim popullsie pa zhurmë. Dhe se fëmijët e tij nuk i largoi mërzia, por mungesa e shpresës. Dhe indianët, bangladeshasit, afrikanët që vijnë në Shqipëri nuk gjejnë këtu ëndrën europiane, por një formë tjetër mbijetese.

Zhvillimi i vërtetë ndodh kur një vend ngre pagat, tërheq talentet, i jep dinjitet profesionit dhe krijon shtresë të mesme produktive. Shqipëria nuk po bën asnjërin prej këtyre. Shqipëria po eksporton rininë e vet dhe po importon skamje të huaj. Në vendet ku shqiptarët emigrojnë, punëtorët e huaj plotësojnë mungesat në sektorë me vlerë të shtuar, në teknologji, ndërtime, kujdes shëndetësor. Në Shqipëri ata zëvendësojnë punëtorët që janë detyruar të ikin për mbijetesë, për rroga që nuk sigurojnë jetë. Dhe jo në sektorë prodhues.

"Është moderne të kesh punëtorë të huaj në çdo cep të qytetit", më shkruan një e njohur rehatuar me projekte të shoqërisë civile. Por hesht pasi i gjej se s'ka asgjë moderne në faktin që një vend i varfër, me një shtresë të hollë oligarkësh, po zëvendëson njerëzit e vet, jo për zhvillim, por sepse nuk ka kush t'i shërbejë. Rinia shqiptare nuk po ikën sepse nuk ka punë. Po ikën sepse s'ka më kuptim. Sepse puna këtu nuk të jep as dinjitet, as siguri, as të ardhme. Kurse Shqipëria zëvendëson të rinjtë me krahë pune më të lira, që nuk ankohen, nuk votojnë, nuk protestojnë.

"Kjo është Tirana kozmopolite pramam", më thotë vajza ime adoleshente ndërsa qesh me hutimin tim. Por i kthehem se e hutuara është ajo. T'i thuash Tiranës "kozopolite" sot, sepse ka më shumë indianë, filipinas dhe bangladeshas në punët e lodhshme është një keqkuptim i thellë. Sepse një qytet bëhet kozmopolit kur përthith kultura, ide, dije, investime dhe ndërton bashkëjetesë mbi respekt të ndërsjellë dhe standarde të larta jetese, jo kur mbush boshllëkun e emigracionit të vet. Të jesh kozmopolit nuk do të thotë të largosh fëmijët e tu dhe të mbushësh sheshet me njerëz që nuk dinë ç'është ky vend, por kur ruan identitetin tënd dhe ia hap derën botës në mënyrë të barabartë. Në Tiranën "kozopolite" të ditëve tona, shqiptari nuk përfaqësohet më, por zëvendësohet. Dhe ky nuk është globalizim, por zbrazje e or-

ganizuar.

Për më tepër, kozmopolitizmi kërkon sistem, kulturë institucionale dhe standard social. Tirana nuk i ka këto. Ka vetëm ndërtime, beton pa mbarim dhe punë të paguara keq.

E si mund të ndërtohet shtet o lum miku mbi importin e varfërisë, ndërkohë që eksporton çdo ditë inteligjencën, forcën dhe shpresën e vendit tënd?!

Kur iu ktheva picës pas vërshimit të 1001 mendimeve që ftohur. Qe bërë bajate. Një shije e thartuar më pushtoi laringun dhe çuditërisht nuk përtova të ziej një vezë e të kripos një domate për darkë. Ndoshta nga një frenim prej nënvetëdijes si formë mbrojtjeje ndaj një tjetër shpërndarësi indian, që me shqipe të sakatuar e pagë minimale do më uronte natën e mirë tek dera e shtëpisë në qytetin ku jam lindur, rritur e ku jam bërë nënë.

Dhe Tirana nuk ka ndryshuar se ka ardhur bota tek ne. Ka ndryshuar sepse ne kemi ikur prej saj. Të huajt nuk janë problem, por boshllëku që i pret është. Sepse qyteti nuk bëhet më i mirë kur mbushet me të panjohur, por kur ata që e ndërtuan ndihen ende pjesë e tij. Dhe kjo ndjesi po shuhet, qetësisht, pa rezistencë çdo ditë.

Një qytet nuk e gjen shpirtin tek ata që e mbushin përkohësisht, por tek ata që e kujtojnë si shtëpi edhe kur janë larg. Dhe zgjedhin një ditë të kthehen për ta dashur sërish.

**TELEFONONI SHQIP
07468 759953**



**141 CHRISTIAN STREET
LONDON E1 1RS
TEL: 02081096550**

**A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST
I KUALIFIKUAR?**

**A DËSHIRONI
GOLD CARD?**



**18 edition - Level 3 Award in the
Requirements for Electrical
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical
Installation Inspection,
Testing, Certification and
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing
Electrotechnical Systems and
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of
Occupational Competence**



**COLLEGE OF
LONDON ME
PRONAR SHQIPTAR**



**www.collegeoflondon.org.uk
info@collegeoflondon.org.uk**

Britania duhet të "përgatitet në mënyrë aktive" për një sulm "të drejt-përdrejtë" ndaj vendit në një "skenar luftime", është konkluzioni i qeverisë mbi kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare.

Në një vlerësim të ashpër, rishikimi kombëtar i sigurisë thotë se "për herë të parë pas shumë vitesh" është në rritje mundësia e një sulmi shtetëror në tokën britanike.

Raporti shton se kundërshtarët e Britanisë tashmë "po vendosin themelet për një konflikt të ardhshëm" duke u pozicionuar për të "shkaktuar ndërprerje të mëdha në energjinë dhe/ose zinxhirët tanë të furnizimit", për të "na penguar të përballemi me agresionin e tyre".

Në veçanti, raporti thekson kërcënimet ndaj kabllave dhe tubacioneve nënujore të Britanisë, nga të cilat vendi varet për 99 për qind të komunikimeve digjitale dhe rreth tre të katërtat e furnizimit me gaz. Thuhet se këto tani janë një "objektiv" për shtetet armiqësore dhe përfaqësuesit e tyre.

Raporti paralajmëron se Mbretëria e Bashkuar është e cenushme ndaj kërcënimeve nga armë të reja kimike dhe biologjike, si edhe ndaj veprimtarive armiqësore si "vrasje, frikësim, spiunazh, sabotim, sulme kibernetike dhe forma të tjera ndërhyrjeje në

demokraci".

Qeveria deklaroi se ka në plan të forcojë "mbrojtjen e brendshme", përfshirë fokusin në "mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare dhe kundër sabotimeve gjatë krizave". Gjithashtu synon të organizojë "ushtrime kombëtare" çdo vit për të testuar "gatishmërinë gjithëshoqërore" të Mbretërisë së Bashkuar. Një rrjet qendrash kombëtare të biosigurisë do të krijohet me një investim mbi 1 miliard £ për të forcuar mbrojtjen ndaj incidenteve, aksidenteve dhe sulmeve biologjike.

Raporti thotë se Mbretëria e Bashkuar duhet të "ashpërsojë dhe përforcojë" qasjen ndaj sigurisë kombëtare në "të gjitha fushat e politikës" dhe bën thirrje për një "ndryshim kulturor të madh në qeveri për të na ndihmuar të lundrojmë në epokën e re ku ndodhemi".

"Duhet të jemi më të vendosur dhe sistematikë në ndjekjen e interesave tona kombëtare", thuhet në raport. "Për herë të parë pas shumë vitesh,

"VRASJE, SPIUNAZH, SABOTIME"

ZBULOHEK RAPORTI SEKRET I QEVERISË BRITANIKE: DUHET TË PËRGATITEMI TANI PËR NJË SKENAR LUFTE

duhet të përgatitemi në mënyrë aktive për mundësinë që territori i Mbretërisë së Bashkuar të përballlet me kërcënim të drejtpërdrejtë, ndoshta në një skenar luftime."

Raporti përfshin detaje nga një auditim mbi Kinën, i kryer nga zyrtarë, i cili përiqej të vlerësonte kërcënimin që paraqet fuqizimi i vendit dhe përparimi i tij teknologjik.

Në parlament, sekretari i jashtëm David Lammy tha se qeveria nuk do ta publikojë auditimin sepse detajet mund të dëmtojnë interesat kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar. Megjithatë, ai tha se auditimi "nënvizoi shkallën e mbështetjes së Pekinit për Kremlinin" dhe shtoi se për këtë arsye Britania po investon 600 milion £ në shërbimet e inteligjencës dhe "po përditëson ligjin për kërcënimet shtetërore".

Ai shtoi: "Auditimi përshkroi një gamë të plotë kërcënimesh, nga spiunazhi dhe sulmet kibernetike deri të shtypja e qytetarëve të Hong Kongut dhe sulmet ndaj rendit ndërkombëtar

të bazuar në rregulla."

"Sqaroi se mbrojtjet tona duhet të shtrihen më gjerë se sa janë aktualisht, nga siguria e këtij Parlamenti deri te infrastruktura jonë kritike kombëtare."

Por ai këmbënguli se në fusha të tjera auditimi tregoi nevojën për bashkëpunim me Kinën, përfshirë në fusha si tregtia dhe ndryshimet klimatike.

Auditimi deklaronte se Kina po përjeton një "modernizim të shpejtë ekonomik, ushtarak dhe teknologjik në një shkallë të paprecedentë në historinë botërore".

Veprimet e Pekinit, nga siguria ndërkombëtare te ekonomia globale dhe klima, kanë potencial të kenë "ndikim të rëndësishëm në jetën e qytetarëve britanikë". Strategjia paralajmëron se "raste të spiunazhit nga Kina, ndërhyrjes në demokracinë tonë dhe minimin e sigurisë sonë ekonomike janë shtuar vitet e fundit".

Thuhet: "Çdo shtyllë e kornizës

strategjike përmban masa të dizajnuara për të forcuar sigurinë tonë të përgjithshme përballë Kinës dhe aktorëve të tjerë shtetërorë që kanë aftësinë të minojnë sigurinë tonë... Prandaj auditimi për Kinën rekomandon rritjen e kapaciteteve për Kinën në të gjithë sistemin e sigurisë kombëtare për të forcuar aftësinë për t'u angazhuar, si edhe qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë tonë bazuar në njohuri dhe trajnim më të thellë."

Pat McFadden, ministër në Zyrën e Kabinetit, u tha deputetëve se strategjia do të ndihmojë në mbrojtjen e Mbretërisë së Bashkuar në vend dhe jashtë saj, ndërkohë që do të investohet më shumë në inteligjencën artificiale dhe mbrojtje.

Ai u tha deputetëve: "Kur kryeministri foli në Parlament në shkurt, ai premtoi të prodhonte një strategji të sigurisë kombëtare që do të përputhej me përmasat e detyrës përpara nesh dhe strategjia që publikojmë sot e bën këtë me një plan që është realist dhe i ashpër për sfidat me të cilat përballemi."

Dotech
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

**TRANSPORT
APOLLONIA**



**TRANSPORT
MAKINASH
ANGLI-SHQIPËRI**

00447429200952

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI
MAKINA
MOTORCIKLETA
PJESË MAKINASH
MAKINERI BUJQËSORE
MOBILJE
FASADA XHAMI
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



00355682948843

00355694031009

00447429200952

**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-SHQIPËRI
SHQIPËRI-ANGLI**



www.transportapollonia.co.uk



ARBEN MANAJ

Kriza e gomoneve qe kalojne ilegalisht kanalin e La Manshit mes Anglise dhe Frances, po perkeqesohet, pranon me ne fund Downing Street. Kjo deklarate behet pas takimit te kryministri britanik Sir Keir Starmer dhe presidentin francez Macron ne samitin e G7 ne Kanada, per te gjetur rruget per frenimin e migracionit ilegal drejt Britanise.

Besohet se kjo eshte hera e pare qe zyra e Kryeministrit britanik, qe ka deklaruar ne menyre kategorike se saga e gomoneve po perkeqesohet dhe jo e kunderta.

Dy liderat sipas qeverise britanike kane rene dakort te gjetjen e rruge inovative per te luftuar gomonet qe mbrijne ne brigjet angleze.

E ndersa Starmer, u nenqesh kur i tha

Melonit se Britania eshte ne krye te luftes globale ndaj grupeve te trafikanteve te qenieve njerezore, shifra e te mbriturve ka shkuar ne nivel shokues, ku 16 mije emigrante ilegal kane kaluar me sukses udhetimin e rrezikshem neper kanalin detar mes Frances dhe Anglise.

Kalimet me gomone jane momentalisht 42 perqind me shume kete vit se vitin e kaluar. Edhe pse Britania i ka paguara Frances 480 milione sterlina per te paguar policine dhe forcat franceze te pengojne gomonet nga mbushja dhe nisja e udhetimit drejt Anglise, francezet thone se nuk mund te nderhyjen ne momentin kur

gomonet jane ne det edhe duke u mbushur me emigrante, pasi bie ne kundershtrim me ligjet e detit dhe rrezikon jeten e njerezve neper gomone, nderkohe qe nuk arrijne te frenojne mbritjen ne kete pike, ku ata nuk bejne gje tjeter vetem se bejne foto dhe filmojne, pa u kuptuar se per cfare arsye. Britaniket kerkojne te ndryshojne kete status-quo, por kjo do varet edhe nga gatishmeria e francezeve qe ne fund te fundit, nga kalimet ilegale, vetem perfitojne zbrasjen e vendit nga emigrantet ilegal qe me pas i mbesin ne dere britanikeve, sidomos pas Brexitit.

KEIR STARMER PRANON DESHTIMIN NE LUFTEN NDAJ GOMONEVE!



Një projektligj historik që u jep të drejtën për vdekje të asistuar pacientëve në fazën terminale është miratuar në Dhomën e Komunave në Angli dhe Uells, duke hapur rrugën për një nga ndryshimet më të mëdha në legjislacionin e kujdesit në fund të jetës.

Projektligji i propozuar nga deputetja laburiste Kim Leadbeater kaloi me një shumicë të ngushtë – 314 vota pro dhe 291 kundër – dhe parashikon që të sëmurët me më pak se gjashtë muaj jetë, pas vlerësimit nga dy mjekë dhe një panel profesional, të kenë të drejtën të zgjedhin një fund të kontrolluar të jetës së tyre.

Kryeministri Keir Starmer votoi pro, ndërsa

qeveria lejoi një votë të lirë për deputetët. Nisma tani pritet të shkojë në Dhomën e Lordëve, ku pavarësisht kundërshtimeve të forta, përfshi nga përfaqësues të kishës dhe aktivistë të personave me aftësi të kufizuara, projektligji pritet të ecë përpara.

Mbështetësit e konsiderojnë një hap drejt dhembshurisë dhe dinjitetit, ndërsa kundërshtarët paralajmërojnë për rreziqet e presionit ndaj të dobëtëve dhe mungesës së mbrojtjes së mjaftueshme ligjore. Sipas nis-

mës, çdo rast do të kalojë në filtër të rreptë nga autoritetet mjekësore dhe ligjore.

Nëse miratohet përfundimisht, projektligji pritet të hyjë në fuqi brenda katër viteve, duke i dhënë kohë sistemit shëndetësor dhe qeverisë për përgatitjen e zbatimit praktik.

MIRATOHET PROJEKTLIGJI! BRITANIA DHE UELLSI DREJT LEGALIZIMIT TË VDEKJES SË ASISTUAR PËR TË SËMURËT TERMINALË, JA SI DO TË FUNKSIONOJË



Dotech

website 

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

The Albanian 

Dotech

website 

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
rregjistruar në
Google?



Our Services:

- Business Cards
- Banners
- Flyers
- Video Marketing

Contact Us 



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT



– Vështrim për librin e Daut Dautit *Britain, the Albanian Question and the Fall of the Ottoman Empire, 1876-1914* [Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Osmane 1876-1914], botuar nga shtëpia e njohur botuese, Bloomsbury Academic –

Nga: Robert C. Austin, profesor në Universitetin e Torontos / Canadian Slavonic Papers
Përktheu: Agron Shala

Ky është një libër i shkëlqyer. Pikë. Dauti është një autor dhe studiues i jashtëzakonshëm, puna e të cilit për periudhën para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë tashmë është e njohur gjerësisht. Ky botim, tejet i kuptueshëm dhe i lehtë për t'u lexuar, është plot me të xhevahire që na ndihmojnë të kuptojmë se si mbijetuan (por, rrallëherë lulëzuan) shtetet e vogla në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë.

Fokusi te Britania është çelësi i origjinalitetit të librit. Dauti ka të drejtë kur thekson se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte interesa të mëdha apo të drejtpërdrejta në Shqipëri, dhe pikërisht kjo ishte arsyeja se pse shqiptarët shpresuan për ndihmë prej saj. Kush më mirë sesa një fuqi e paanshme për t'i shpëtuar ata nga fqinjët e këqij? Sidoqoftë, aty ku Dauti pasuron njohurinë tonë për atë periudhë është pikërisht roli që luajti Mbretëria e Bashkuar në çështjet shqiptare.

Pasi përshkruan shqiptarët më 1878 me themelimin e Lidhjes së Prizrenit, Dauti analizon se si u pasqyrua e gjithë kjo në Londër dhe në Stamboll. Dauti e vendos politikën e jashtme britanike ndaj shqiptarëve brenda pozicioneve liberale dhe konservatore. Liberalët e shihnin fenë si “një element thelbësor në ngritjen e ndjenjës kombëtare në Ballkan” (32). Kjo qasje nuk paralajmëronte gjë të mirë për shqiptarët me shumicë myslimane, pasi Britania i paramendonte të krishterët si të jetonin në një shtet “barbar” mysliman. Për më tepër, siç shton Dauti, udhëtarët britanikë që kishin ndikim shpeshherë i kishin sharë shqiptarët.

Më vonë, edhe prezantimi në shtyp i Luftërave Ballkanike (1912-1913) pasqyrore këtë mënyrë të menduarit dhe ishte haptazi antimysliman në pothuajse çdo aspekt. Sikur të mos mjaftonte kjo, edhe myslimanët e tjerë ua bënë jetën të vështirë rilindësve shqiptarë, siç tregon histo-



ria e pasojave të revolucionit xhonturk. Elita shqiptare shpejt e kuptoi se “Xhonturqit janë bijtë e të vjetërve” (94). Gjuha shqipe, çelësi i idesë kombëtare shqiptare, meqenëse feja nuk mund të shërbente si faktor unifikues, u shtyp nga një kërcënim tjetër kombëtar: turqizmi.

Sa për Britaninë, kur shpërtheu Lufta e Parë Ballkanike gjërat nuk u përmirësuan, pasi mbizotëroi qasja liberale dhe lufta u pa në thelb si një luftë e drejtë për të çliruar të krishterët.

Duke parë se gjithçka ishte kundër shqiptarëve, është e jashtëzakonshme që ata arritën pavarësinë. Kjo histori, megjithëse e treguar mirë më parë, rrefehet sërish me vështrime të reja

nga Dauti. Përderisa Shqipëria dhe shqiptarët kishin qenë kryesisht dytësorë për Britaninë, më 1912 gjërat ishin ndryshe. Shqipëria nuk mund të injorohej.

Në kapitullin 7, “Ballkani për popujt ballkanikë”, më pëlqeu shumë shkrimi i Dautit mbi kontributin e Edith Durhamit në çështjen shqiptare. Për të qenë i sigurtë, nuk lodhem kurrë nga analiza e saj shpesh therëse dhe e drejtpërdrejt për Ballkanin dhe shqiptarët në veçanti. Edhe pse fillimisht mendonte se rajoni kishte nevojë për një sundimtar të krishterë, më vonë u bë mbështetëse e kauzës kombëtare shqiptare, të cilën e shihte si qendrore për zgjidhjen e problemit ballkanik.

Në fund, ishte Austro-Hungaria ajo që



Daut Dauti
BRITAIN, THE
ALBANIAN
QUESTION AND
THE FALL OF
THE OTTOMAN
EMPIRE, 1876-1914

BLOOMSBURY

shpëtoi Shqipërinë dhe shqiptarët, pasi ishte e vetmja fuqi gjatë Konferencës së Londrës që tregoi se mund të shkante në luftë për Shqipërinë.

Në anën e shqiptarëve ishte parlamentari dhe diplomati i palodhur britanik, Aubrey Herbert, i cili me këmbëngulje mbrojti parimin etnik në përcaktimin e kufijve të rinj të Shqipërisë – kufij të cilët, në fund, sipas Herbertit, fatkeqësisht u dhanë atyre vetëm “shkëmbinj, gryka dhe përranj malorë” (147). Britania, siç vëren Dauti, nuk kishte interes për një Shqipëri etnike që përfshinte të gjithë shqiptarët dhe qëndroi besnike ndaj synimeve të veta strategjike.

Kur Konferenca e Londrës përfundoi punën në gusht të vitit 1913, gjithçka

që i duhej ishte të gjente ndonjë princ të papunë gjerman për të sunduar vendin. Herberti paralajmëroi me zgjuarsi se gjetja e dikujt që ishte i përshtatshëm do të ishte punë e vështirë. Ai i shkroi vëllait të vet: “Çdo princ do të ishte budalla ta pranonte po ta dinte vështirësinë, dhe edhe më budalla po të mos e dinte” (151). Kështu filloi një varg i gjatë e budallenjve që sunduan Shqipërinë.

E pavarur, por e privuar nga tokat e rëndësishme shqiptare, vendi pa të zbehej mbështetja për procesin e shtetndërtimit. Ana pozitive ishte se sovraniteti i shkurtër të cilin Shqipëria arriti më 1913, padyshim e shpëtoi nga zhdukja pas Luftës së Parë Botërore. telegrafi

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



DW

Aktualisht ka rreth 1000 emigrantë në B-H. Po cili do të jetë fati i planit të Mbretërisë së Bashkuar për të vendosur emigrantët në Ballkanin Perëndimor?

Kanë kaluar shtatë vjet që nga vala e parë e migrantëve që hynë në Bosnjë-Hercegovinë në numër të madh, pasi Hungaria dhe Kroacia mbyllën kufijtë e tyre në vitin 2015.

Që atëherë, mijëra migrantë kanë qëndruar në Bosnjë-Hercegovinë, disa prej të cilëve kanë mbetur në vend, ndërsa të tjerë kanë gjetur strehim në vendet e BE-së dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Këta të fundit mund të pësojnë të njëjtin fat nëse plani i qeverisë britanike për të arritur një marrëveshje me Serbinë, Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, të cilën kryeministri Edi Rama e ka hedhur poshtë, rezultoi i saktë.

Megjithatë, Shtetet e Bashkuara kanë arritur një marrëveshje me Kosovën për të strehuar rreth 50 migrantë që do të deportohen nga SHBA-ja, gjë që mund të konfirmojë njoftimet e mëparshme se administrata Trump do ta përdorë Ballkanin Perëndimor si qendër deportimi.

Trafikimi i migrantëve

Sa i përket B-H, kjo çështje është rishfaqur pas valëve të migrantëve të viteve të fundit, në të cilat dhjetëra prej tyre kanë humbur jetën duke kaluar kufijtë ilegalisht.

Gjithçka ka marrë edhe një dimension politik, pasi njoftimi nga Britania e Madhe për deportimin në B-H nuk mund të zbatohet derisa të nënshkruhet një marrëveshje ripranimi, e cila kërkon pëlqimin e të tre grupeve etnike në B-H, gjë që do të jetë e vështirë të ndodhë nëse nuk ka ndonjë interes të fshehur

PLANI I LONDRËS PËR MIGRANTËT, A RREZIKON BALLKANI TË BËHET 'DEPO' E TYRE? DW ANALIZË: PROJEKT-SKEMA BRITANIKE NËN PIKËPYETJE



ose "shlyerje borxhi".

Republika Serbe ishte e para që kundërshtoi një plan të tillë, prandaj është planifikuar një seancë e Asamblesë Kombëtare të RS për të marrë një qëndrim mbi çështjen e migrantëve në territorin e këtij entiteti. Edhe pse nuk ka konfirmim zyrtar, nuk ka mundësi deportimi, sepse nuk ka marrëveshje për këtë.

"Ne nuk do të jemi parking për këtë ndërsa unë drejtoj Republikën Serbe. B-H nuk do të nënshkruajë një marrëveshje me asnjë vend evropian për të pranuar migrantët që i kanë ftuar të vijnë tek ata.

Ne nuk i kemi ftuar ata dhe nuk duam të pastrojmë rrëmujën e tyre që kanë lënë në këtë drejtim", tha presidenti i RS Milorad Dodik.

Ai i dërgoi një nismë parlamentit për të shqyrtuar informacionin në lidhje me migrantët në mënyrë që "të miratohen masa në lidhje me njoftimet e qeverive të Britanisë së Madhe dhe vendeve të tjera në kohën e duhur".

Dodik kritikoi opozitën e RS, e cila është përpjekur të largojë SNSD-në nga pushteti muajt e fundit, se

është gati të bëjë gjithçka për disa pozicione në Sarajevë, përfshirë importimin e migrantëve.

Anëtari i Bordit Kryesor të SDS-së, Marinko Bozhoviq u përgjigj menjëherë.

"Nëse do t'ju ofronin heqjen e sanksioneve, nuk do të mendohej dy herë," shkroi ai në Facebook, duke iu përgjigjur Dodikut.

Mbërritja e migrantëve në kampet e mbyllura?

Aktualisht ka katër kampe për migrantë në B-H – Lipa dhe Boriqi si dhe Blazhuj dhe Ushivak. Për shkak të rrezikut të lartë të sigurisë, është krijuar nisma për të mbyllur urgjentisht kampin Blazhuj.

"Kampi i migrantëve dhe të gjitha krimet që po shohim, përfshirë vrasjet, po krijojnë një problem të madh për popullsinë lokale dhe zhvillimin e komunës Ilixha," tha përfaqësuesi i SDP në parlament Sasha Maganoviq, i cili është nismëtar i mbylljes së kampit.

Megjithatë, për të mbyllur një kamp, është e nevojshme të hapet një i ri që do të plotësonte të gjitha nevojat për pritjen e përkohshme të

migrantëve, sipas Shërbimit për Çështjet e të Huajve.

"Pavarësisht se çfarëmigrantëshjanë, ne i pranuar, ndërsa ata bëjnë gjithçka. Do t'i dëboja të gjithë nga këtu. Le të ktheheshin në vendet e tyre ose të shkojnë në Evropë. Ata hapën kufijtë për ta", thonë disa qytetarë të Sarajevës.

"Miq britanikë"

Jo shumë kohë pas krizës më të madhe të emigrantëve në B-H kur disa qendra u dogjën e disa u mbyllën, qindra emigrantë pritën me ditë të tëra një vendim nga autoritetet për fatin e tyre.

Pas kësaj u krijuan katër kampe, por situata e sigurisë aty është jashtëzakonisht e pafavorshme. Popullata dhe disa politikanë kërkojnë mbylljen e disa prej tyre. Sidomos pas njoftimeve se numri i migrantëve mund të rritet nëse njoftimet për deportimin e tyre në vendet e Ballkanit Perëndimor rezultojnë të vërteta.

Nga ana tjetër, ministri i Punëve të Jashtme i B-H, Elmedin Konakoviq, thotë se nuk ka informacion në lidhje me deportimin e

mundshëm të emigrantëve, por ai është gati të flasë.

"Ne nuk do të jemi kurrë pjesë e zgjidhjes së problemit të dikujt tjetër. Nëse kjo është nisma e miqve tanë nga Britania e Madhe, ne do të themi seriozisht dhe me argumente se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë B-H", thotë Konakoviq.

Depo për migrantët

Shërbimi për Çështjet e të Huajve në B-H thotë se në këto kushte, pranimi i migrantëve nga Britania e Madhe është i pamundur.

"Nuk e kuptoj se si kanë ndërmend ta bëjnë këtë. B-H nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje me Britaninë e Madhe", tha drejtori i Shërbimit për Çështjet e të Huajve, Zharko Laketa.

Lidhur me nismën për të krijuar të ashtuquajturën Qendër Kthimi në vendet e treta për azilkërkuesit, Human Rights Watch njoftoi se Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe duhet të ndalojnë së përdoruri Ballkanin si një "depo për migrantët".

"Në vend që ta trajtojnë Ballkanin si një depo për emigrantët, BE-ja dhe Mbretëria e Bashkuar mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit të sistemeve funksionale të azilit dhe kornizave më të mira për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve", kumtoi organizata e të drejtave të njeriut.

Ajo përmendi shembullin e Bosnjë-Hercegovinës si një vend që tashmë po përdoret "si një vend grumbullimi për njerëzit që aksidentalisht e gjejnë veten në tranzit për në BE"./DW

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



#BreakingTheChains

Forest Gate Youth Club

Immigration advise

Sports & Dancing

Peer support

General info and support


Come Dine with Me



Join us

every Monday evening 6-9pm

 1 Woodford Road,
Forest Gate,
London, E7 0DH

 07494974957


Shpresa Programme

Inspiring hope & change

Akoma nuk keni një Website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

OUR SERVICE :

- Business Cards
- Banners
- Video Marketing
- Logos
- Etc

Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të vini nga zyrat tona

Adresa e zyrave
30 Avenons Road,
London E13 8HT



Na kontaktoni

Tel: 020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545

DEFAKTORIZIMI I SHQIPTARËVE I SHTYN INDIVIDËT NË KURTHIN E VEPRIMEVE STIHIKE

SKENDER ASANI

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut ndodhen ende në një udhëkryq mes kujtesës historike dhe një të ardhmeje që vazhdon të shtyhet, përballë një realiteti ku përfshirja shpesh është më shumë simbolike sesa substanciale. Në këtë kontekst, marginalizimi institucional dhe zvarritja e proceseve integruese nuk janë thjesht pengesa politike, por shenja të një rendi që synon thellimin e pabarazisë strukturore.

Në hapësirat ku kujtesa kolektive endet mes rrëfimeve të pathëna dhe heshtjeve të institucionalizuara, shqiptarët në pjesën perëndimore të Ballkanit mbeten një popull që vazhdon të dialogojë me kohën jo si bashkëbisedues të barabartë, por shpesh si palë që ftohet të dëgjojë më shumë sesa të flasë. Historia e tyre është një udhë që përshkon shekujt me barrën e një pritjeje të gjatë, që përherë ka kërkuar një vend mes hijeve të së kaluarës dhe dritës së një të ardhmeje ende të papërcaktuar.

Në periudha të ndryshme të historisë, shqiptarët janë shfaqur si subjektë të një procesi që ka lëvizur ndërmjet përfshirjes së përkohshme dhe përjashtimit të qëndrueshëm. Nga roli i tyre në administratat e mëdha të Perandorisë Osmane, te Lidhja e Prizrenit që për herë të parë artikuloi ndjenjën e përkatësisë së përbashkët politike dhe kulturore, e deri te etapat e mëvonshme ku ndarja territoriale dhe shpërndarja nën pushtete të ndryshme u bë realitet i dhimbshëm, shqiptarët kanë provuar që koha për ta nuk e kishte pas rrjedhën si të popujve të tjerë.

Në shekullin XX, sidomos pas rishkrimit të kufijve pas dy

luftërave botërore, përvoja shqiptare u përkufizua përmes dualitetit të dukjes dhe mungesës si qytetarë në formë, por periferikë në substancë. Kjo kontradiktë, që mbështillet shpesh në gjuhë diplomatike dhe premtime integruese, nuk arriti të zhbëjë ndarjen strukturore mes popullsisë të barabarta në ligj dhe të pabarabarta në përfaqësim. Rrjedha e kohës, megjithëse mbulohet me formula juridike dhe reforma të shpallura, nuk ka qenë e mjaftueshme për të përmbysur një rend që funksionon mbi modelin e ruajtjes së status quo-së.

Në realitetin pas Marrëveshjes së Ohrit, retorika e përparimit gradual u bë shpesh një dritë që më shumë verboi sesa ndriçoi. Premtimet për barazi, të shprehura në gjuhë diplomatike, nuk u pasuan me ndryshime të thella strukturore, por me ritme të kontrolluara të përfshirjes. Shqiptarët u bënë pjesë e skenës institucionale, por shpesh si pjesë dekorative të një projekti që e konsideron integrimin si një proces simbolik, e jo transformues.

Në këtë sfond të tensionuar, është e rëndësishme të vihet re se elitat politike maqedonase kanë filluar të veprojnë në mënyrë të koordinuar në disa drejtime që, nëse nuk dekodohen me kujdes, mund të interpretohen si zhvillime të zakonshme politike, por në thelb bartin implikime të thella për arkitekturën e bashkëjetesës. Njëra prej këtyre linjave është përpjekja për të zhbërë, ose së paku për të minimizuar arritjet e shqiptarëve në drejtim të shtetformimit, duke ndaluar me metoda të heshtura avancimin e tyre të mëtejshëm në fushat vendimmar-



rëse të shtetit. Një drejtim tjetër është instrumentalizimi i krizave të brendshme dhe nxjerrja e problemeve të reja politike, për të zvarritur qëllimisht proceset kyçe, siç është integrimi evropian, ku shembull më tipik mbetet vonesa në realizimin e ndryshimeve kushtetuese të dakorduara në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Kjo vonesë nuk është vetëm çështje e politikës së brendshme, por ajo reflekton një përputhje të heshtur me interesat gjeopolitike të faktorëve që ndikojnë jashtë institucionalitetit evropian, veçanërisht me prijet serbo-ruse që gjejnë rezonancë në disa segmente të elitave maqedonase në pushtet.

Drejtimi i tretë është më i ndërlikuari: përmes defaktorizimit të shqiptarëve dhe marginalizimit të tyre në jetën publike, krijohet një ambient ku vetë mungesa e alternativave i shtyn individët dhe grupet drejt veprimeve stihike dhe të pa menduara mirë, duke përgatitur terrenin për etiketime që nuk reflektojnë realitetin, por shërbejnë si

justifikime për kontroll më të fortë.

Në këtë rrjet kompleks të qëllimeve të kamufluara dhe narrativave të ndërtuara, elitat politike shqiptare përballen me një sfidë të re: të mos bien në grackën e një rendi që kërkon të vendosë kufij të rinj brenda të drejtave të fituara. Në vend të reagimeve të fragmentuara, koha kërkon një qasje të koordinuar një rezistencë politike dhe institucionale që e ka bazën në vetë frymën e Marrëveshjes së Ohrit, e cila nuk përjashton askënd, por reformon shoqërinë përmes barazisë së përbashkët.

Ky projekt nuk bie ndesh me proceset integruese euroatlantike përkundrazi, është i vetmi koncept që siguron që rruga drejt Europës të jetë gjithëpërfshirëse dhe pa tensione të trashëguara.

Përmes unitetit dhe një vetëdijeje të kthjellët për domosdoshmërinë e shtetformimit të barabartë, shqiptarët mund të ndërtojnë një model që jo vetëm sfidon marginalizimin,

por e tejkalon atë në mënyrë dinjitoze dhe progresive.

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut ndodhen ende në një udhëkryq mes kujtesës historike dhe një të ardhmeje që vazhdon të shtyhet, përballë një realiteti ku përfshirja shpesh është më shumë simbolike sesa substanciale. Në këtë kontekst, marginalizimi institucional dhe zvarritja e proceseve integruese nuk janë thjesht pengesa politike, por shenja të një rendi që synon thellimin e pabarazisë strukturore. Përballë kësaj, kërkohet një vetëdije e re politike dhe një veprim i koordinuar nga elitat shqiptare, që ta shndërrojë pjesëmarrjen në mekanizëm të vërtetë ndikimi, duke ndërtuar një model shtetformimi të barabartë, që jo vetëm sfidon status quo-në, por hap perspektivën për një të ardhme të përbashkët dhe të drejtë.

Nëse koha vazhdon të ngurojë, atëherë mbetet mbi ndërgjegjen e brezit të sotëm barra për të mos qenë më pritës pasivë, por subjekt aktivë të një drejtimi të ri. Jo përmes konfrontimit, por përmes ripozicionimit strategjik që i rikthen shqiptarët nga periferi e pjesëmarrjes simbolike në boshtin e barazisë substanciale.

Kjo nuk kërkon thirrje të mëdha, por hapa të qartë dhe të koordinuar që e rishkruajnë marrëdhënien me shtetin jo si dorëzim ndaj një rendi të dhënë, por si projektim i një vizioni të përbashkët. Sepse ndërtimi i së ardhmes nuk është vetëm çështje kohe – është akt vullneti, përgjegjësie dhe guximi për ta tejkaluar heshtjen me mendje të kthjellët dhe qëllim të përbashkët.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



SONILA MEÇO

PASQYRAT NUK JANË KËRCËNIM, VEÇ NËSE KE FRIKË T'I SHOHËSH

Debatet që pasuan publikimin e një artikulli kritik për qeverisjen shqiptare në një nga platformat më të njohura të medias amerikane Fox News nuk kanë të bëjnë me një tekst të izoluar. Ato kanë të bëjnë me raportin që një vend ka me lirinë e shprehjes dhe vetëdijen e qartë të pushtetit se ai artikull/opinion a çfarëdo emri t'i vënë reflekton bindje përtej kokës së diplomatit Agim Nesho.

Mu bash për këtë propaganda hyri shpejt në kundërveprim dhe e orientoi reagimin publik drejt formës. Një paragraf u përqendrua nëse ai i Agim Neshos që artikull apo opinion, një tjetër nëse autori ka histori politike e anshmëri dhe syresh të tjerë nëse platforma ka qëndrim zyrtar. Por kjo nuk është analizë. Kjo është shmangie.

Rubrika "Opinion" në Fox News, si në çdo media serioze, ka lexueshmëri masive dhe ndikim të madh politik. Vetë fakti që një shkrim kritik ndaj kryeministrit shqiptar botohet aty, tregon një alarm ndërkombëtar, jo një "keqpërdorim të hapësirës".

Në çdo demokraci funksionale, një opinion i fortë, qoftë dhe nga një ish-diplomat, është një instrument legjitim i komunikimit politik dhe



diplomatik. Aty ku sistemi është i sigurt në themelet e tij nuk ka nevojë për ta zhvlerësuar qëndrimin kritik përmes etiketash, por për ta përballuar me argumente. Aty ku mungon kjo siguri, përpjekja harxhohet e gjitha për të relativizuar zërin që e thotë, jo për të dëgjuar çfarë thotë.

Ky aksion ad hoc i orientuar nga shqetësimi i pushtetit nis prej një premiseje falco dhe mbështetet mbi një logjikë provinciale, jo globale.

Çdo narrativë që futet në qarkullim në media si Fox News, sidomos kur ka fokus gjeopolitik dhe godet një lider aleat të NATO-s është pjesë e një zinxhiri ndikimi më të gjerë, që shpesh nuk ka zhurmë të menjëherëshme. Këto nuk janë kronika banale që presin studiot e mbrëmjes për të matur efektin. Janë gërvishje që çelin rrugë të ndriçuara në terrin informativ a propagandistik që rrethon një autokrat.

Pretendimi se një artikull ka peshë vetëm nëse krijon një efekt të menjëherëshëm në kryeqytete të mëdha është keqkuptim i natyrës së diplomacisë moderne.

Mendimi ndërkombëtar nuk ndërtohet me konferenca për shtyp, por me rrjedhje të qëndrueshme informacioni, perceptimi dhe opinionit. Ai nuk formësohet vetëm nga zyrat, por edhe nga opinione të tilla që pastaj përmbledhen në brief-e, raporte, memo, apo takime të mbyllura.

Një term i ri, një metaforë goditëse, një analizë që qarkullon në medium të madh, janë shpesh më ndikues sesa çdo fjalim zyrtar.

Ndërsa argumenti se opinionit i publikuar nga Fox News paralajmëron për "ndikim negativ në integrimin evropian", e përdor nocionin e "interesit kombëtar" për të heshtur zërat kritikë. Sipas kësaj logjike, çdo kritikë ndaj qeverisë në media ndërkombëtare është sabotim. Kjo është pikërisht mendësia autokratike që Nesho e denoncon.

Në një shtet të kapur, ku mediat janë të dominuara nga klientelizmi,

pro pushtetit (siç e thotë çdo raport ndërkombëtar edhe së fundmi) e vetmja mënyrë për të nxjerrë në dritë të vërtetat e ndaluara është përmes mediave ndërkombëtare.

Një opinion i botuar në një media me lexueshmëri të lartë nuk është vetvetiu fakt, por është një sinjal. Dhe kur sinjali lexohet me nervozizëm, çfarë konfirmohet nuk është gabimi i autorit, as parëndësia e tij, por ndjeshmëria e sistemit ndaj asaj që po ekspozohet.

Nuk ka rëndësi nëse reagimi vjen nga një gazetë apo një qeveri. Nëse përpjekja bëhet për të zhvlerësuar mesazhin përmes reduktimit të figurës, kjo tregon më shumë për klimën e brendshme sesa për vlerën e shkrimit.

Narrativa të tilla nuk përçajnë Shqipërinë, përkundrazi. Ato zbulojnë se sa e përçarë është ajo tashmë.

Dhe kjo nuk është përgjegjësi as e Fox News e as Neshos, që publikon në një medium të kësaj rëndësie, por e atyre që duan të fikin çdo dritë jashtë kontrollit të tyre.

BLEDIAN KOKA

PSE EDI RAMA NUK E PADIT FOX NEWS PËR 'RAMADURON'?

Në 25 Qershor 2019, Edi Rama nisi betejën ligjore në Gjermani ndaj gazetarit të revistës Bild, Piter Tiede për cënim të imazhit pas publikimeve të përgjimeve të prokurorisë të dosjes së famshme "184". Në këto përgjime Edi Rama dëgjohej duke folur me drejtues të policisë lokale të Dibrës dhe përfaqësues të lartë politik të PS-së, përgjime të cilat në thelb tregonin makinerinë shtetërore për të tjetërsuar vullnetin e votuesve të Dibrës në zgjedhjet e pjesshme lokale "Post-Shukri"! Sot 6 vite më pas Edi Rama është në të njëjtën situatë. Madje akoma më shumë, media prestigjioze amerikane (shumë e afërt me administratën Trump) publikoi një analizë të ambasadorit Agim Nesho me titull "Njihuni me Ramaduro: Armiku i Trumpizmit, autokrati euro-progresiv i trajnuar nga Soros".

Në një vend ku kryeministri të padit për një postim, një aludim apo edhe një emoji, lind pyetja legjitime: Si është e mundur që Edi Rama nuk e padit ambasadorin Agim Nesho apo

Fox News, një prej mediave më të mëdha amerikane, që e krahasoi atë me Nicolás Maduron? Jo vetëm kaq, artikulli i publikuar në FoxNews me firëm të ambasadorit Nesho e pagëzoi zyrtarisht Edi Ramën "Ramaduro", një përzierje midis një piktori post-modern dhe një autokrati të Amerikës Latine.

Artikulli që ka bërë xhiron e opinionit konservator në SHBA, me firmën e ish-ambasadorit shqiptar Agim Nesho, thotë hapur se Rama është një "autokrat progresiv i Sorosit", "armik i Trumpizmit" dhe simbol i një demokracie të deformuar.

Dhe Rama? As edhe një status, as një ironi, as një paditje.

E vërteta është që në SHBA, drejtësia nuk është "projekt i qeverisë", drejtësia atje nuk funksionon si në

Tiranë. Nuk ke gjykatë që të ngre moralin me "vendim të formës së prerë". Atje, edhe nëse padit Fox News, e para gjë që të thotë gjykatësi është: "Zoti Rama, opinione politike nuk janë shpifje. A jeni të sigurt që doni të vazhdoni këtë proces?".

Që artikulli i Agim Neshos me vulën e fortë të Fox News ishte gjëja e fundit që i duhej Edi Ramës në SHBA, kjo është pak po e sigurtë. Shikoni sesi në vend të reagimit personal, Edi Rama i ka turrur Ambasadorit Nesho të gjithë enturazhin e tij mediatik nga portali online i Top Channel e deri tek Gazeta Tema! Në një lëvizje të sforcuar editorial, Top Channel publikoi në portalin e vet një artikull me titull "Kur Opinioni maskohet si lajm: Rasti i Agim Neshos në Fox News që nuk përfaqëson pozicionin e medias amerikane, por qëndrimet poli-

tike të një militanti të opozitës". Çuditërisht ky "sforcim editorial" i Top Channel kundër artikulli të ambasadorit Agim Nesho në Fox News erdhi pak ditë pasi pronarët e Top Channel u "bekuan" nga Edi Rama më privilegjet e "investitorit strategjik" që u mendoëson atyre ndërtimin e një kulle në zemër të kodrave të liqenit.

Cilësimi i Agim Neshos në këtë artikull si "militant politik" i opozitës nuk është një ofezë për të, por thjeshtë tregues i frustrimit të fortë të Edi Ramës për ato pak zëra të ndershëm të këtij vendin të cilët ai nuk ka aq para sa ti blejë!

Paditja nuk vlen në një vend si Amerika ku fjala është më e lirë se flamuri, dhe gjykata nuk ka një buton 'mute' për të vërtetën. Prandaj, heshtja e Ramës nuk është thjesht taktikë. Është pranim. Një

goditje mu në zemër të fuqisë së tij të vërtetë që është propaganda. Propagandë të cilën në Shqipëri e blen, por si duket në SHBA nuk e shet dot! Sulmi i orkestruar nga Edi Rama për ta diskredituar shkrimin e Ambasadorit Nesho në Fox News si një "opinion personal", është pikërisht konfirmimi se publikimi në SHBA ishte një goditje që "Ramaduro" i Shqipërisë nuk e priste. Edi Rama e di mirë se artikulli i Ambasador Nesho është një memo e cila ka përfunduar në çdo tryezë konservatore të vendimarrjes aktuale në SHBA!

Dhe sigurisht që ai nuk ka ndërmend të bëjë padi ndaj Agim Neshos, e aq më pak ndaj Fox News. Për momentin shqetësimi i tij vetëm duket se është ekzekutimi i artikullit të Ambasadorit në Shqipëri, përmes "vrasësive publike" të tij me pagesë.

DALLENDYSHE XHAFERRI

“Kendal Global Advisory” pranon kontratën, mbi 5 mijë euro pagesë çdo muaj

Erion Veliaj, kryebashkiaku i Tiranës që prej vitit 2015, është duke u mbrojtur nga një kompani londineze e marrëdhënieve me publikun, “Kendal Global Advisory”, e cila po përpiqet të ruajë dhe forcojë reputacionin e tij ndërsa ai qëndron i izoluar në paraburgim prej 10 shkurtit 2025.

Në një komunikim me “shteg.org”, kompania pranoi se Veliaj është klienti i tyre, ndërkohë që në faqen zyrtare të saj prezantohen projekte suksesi të ndryshme me klientë nga qeveri dhe korporata globale, deri te investitorë strategjikë në Gjirin Per-sik.

Sipas raportimeve të “The PR Insider”, tarifat mujore për shërbimet e kompanive të mëdha të PR-it si “Kendal Global Advisory” arrijnë deri në 25 mijë paund, rreth 29 mijë euro. Një analizë e bërë nga “Essential Content” tregon se mesatarisht këto shërbime kushtojnë rreth 4,672 paund në muaj, ose rreth 5,465 euro.

Përveç kontaktimit me kompanitë e PR-it, sipas analistit Indrit Vokshi, politikanët shqiptarë që kanë probleme me ligjin krijojnë operacione propagande duke dëmtuar imazhin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Rikthimi i Lali Erit

Në epokën e informacionit të shpejtë dhe rrjeteve sociale, reputacioni politik është bërë një aset shumë i brishtë dhe vendimtar për karrierën e çdo figure publike. Ekspertët e komunikimit theksojnë se “menaxhimi i kujdesshëm dhe strategjik i reputacionit shpeshherë përbën çelësin për mbijetesën politike, sidomos kur politikanët përballen me sfida ligjore dhe presion mediatik”. Në këtë kontekst, Erion Veliaj, i cili ndodhet në paraburgim që nga 10 shkurti 2025, pas akuzave të ngritura nga Prokuroria e Posaçme për “korrupsion pasiv” dhe “pastrim parash”, vepra penale këto që dyshohet t’i ketë kryer në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, Ajola Xoxën, duket se nuk ka tjetër rrugë veçse të përpiqet të ruajë dhe të shpëtojë emrin e “mirë të Lali

Erit”.

Ndonëse për 4 muaj ai i ka qëndruar deklaratës së tij se ndodhet i izoluar padrejtësisht, Veliaj i është drejtuar një kompanie angleze të strategjisë së komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun (PR) për të mbrojtur reputacionin.

Me anë të një e-maili të ardhur pranë redaksisë së “shteg.org”, përfaqësues të “Kendal Global Advisory” pranojnë se kryebashkiaku Erion Veliaj është klienti i kësaj shoqërie.

Sipas tyre, është e rëndësishme të theksohet se Veliaj është i arrestuar në bazë të dyshimeve, por ende nuk ka një tregues se kur, apo nëse do të ngrihet akuzat ndaj tij.

“Zoti Veliaj i mohon kategorikisht këto akuzat dhe paraburgimi i tij para gjyqimit është një element që mund të rrezikojë vetë aspiratën e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian” – shkruajnë përfaqësues të Kendal Global Advisory.

Ndërkohë, pyetjet e “shteg.org” se kush është nënshkruesi i kontratës dhe sa ka kushtuar kjo kontratë nuk morën një përgjigje as nga kompania, as nga vëllai i kryebashkiakut, Arbër Veliaj.

Por, sipas një analize të bërë nga “Essential Content” me tarifat mujore fikse të 61 agjencive të pavarura të PR-it në Mbretërinë e Bashkuar, siç është ajo e përzgjedhur nga Veliaj, mesatarisht tarifa mujore që duhet të paguajë klienti për të marrë shërbimin, konsultimin është 4,672.55 paund, ose thënë ndryshe 5,464.63 euro.

Megjithatë, kompania e përzgjedhur prej Veliajt ofron shërbime në shtete të ndryshme të botës në fusha të ndryshme, ku përveç personave fizikë, përfshihet: mbrojtja e reputacionit të personave me përgjegjësi

VELIAJ NË BURG, NJË KOMPANI LONDINEZE PO KUJDESET PËR REPUTACIONIN



shoqërore, çështje gjyqësore të klientëve, këshillim strategjik për korporata të mëdha, si dhe forcim i reputacionit të klientëve në disa nga ngjarjet më të mëdha në botë.

“Në Kendal, ne jemi të përqendruar ekskluzivisht në ofrimin e këshillave me ndikim, që ndihmojnë klientët të menaxhojnë reputacionin e tyre, një faktor kyç i vlerës në botën e sotme”, – kjo është fjalia e parë që lexojnë vizitorët e faqes web të kompanisë së PR-it “Kendal Global Advisory”.

Sipas të dhënave publike “Kendal” rezultoi me vendndodhje në Londër dhe zhvillon veprimtarinë e saj në një gamë të gjerë klientësh në mbarë botën.

“Ne punojmë me një gamë të gjerë klientësh, nga korporata të mëdha deri te biznese të reja (start-up), organizata joqeveritare (OJQ), qeveri, zyra familjare dhe individë me pasuri të konsiderueshme”- thuhet në rubrikën “Rreth Nesh”, ndërkohë që si sukses së saj kompania ndan rastet ku strategjia e ndjekur prej tyre kanë ndihmuar klientët të rrisin reputacionin e tyre, madje dhe të kthehen në investitorë të besueshëm strategjikë.

“Një zyrë familjare e vetme në Lindjen e Mesme na kërkoi ndihmë për të mbrojtur dhe zgjeruar reputacionin e

tyre në sektorë të rinj ku po fillonin të bënin investime strategjike”, – shkruhet në Kendal, ku pasi tregohet se si familja është ndihmuar me anë të përgatitjes së fjalimeve në konferenca dhe artikujve të rëndësishëm për investitorët, është bërë e mundur ndërtimi i imazhit të një investitori të besueshëm, çka është reflektuar dhe në pasurimin më të madh financiar të kësaj familjeje.

Analisti politik Indrit Vokshi vë në dukje se në Shqipëri, kur politikanët përballen me akuzat ligjore, shpesh përdorin strategji të avancuara propagandistike, për të ndikuar opinionin publik dhe për të minuar besueshmërinë e institucioneve të drejtësisë.

“Madje kanë tentuar të krijojnë mendimin sikur politikanët janë të ndershëm por ata janë viktimat të përndjekjes nga prokuroria e gjykata”, – thotë gjatë intervistës për “shteg.org” analisti Voksi.

Një nga strategjitë e ndjekura nga kompanitë e PR-it është dhe publikimi i “punëve të mira” të bëra nga klientët, të cilët duhet tua rikujtojnë vazhdimisht ndjekësve apo audiencës së tyre për të arritur në qëllimin e tyre, fitimin apo rifitimin e besueshmërisë.

Një strategji e tillë, nga hulumtimi në rrjetin social “Instagram” rezultoi të

jetë ndjekur edhe nga Kryebashkiaku Veliaj, cili ndonëse prej 4 muajsh rezultoi i izoluar fizikisht, në hapësirën online vazhdon të mbetet aktiv.

Ai ka qëndruar aktiv më shpërndarjen e përmbajtjeve të ndryshme në rrjetet sociale, duke nisur nga rrëfimet e përditshme për arrestimin e padrejtë, sipas tij, tek ngjarjet kulturore të Tiranës, ndërtimi i objekteve publike të Tiranës gjatë kohës së drejtimit të bashkisë nga ai, ndarja nga jeta e artistëve të kinematografisë dhe Papa Françeskut e të tjerë.

Nga data 10 shkurt deri më 23 qershor Veliaj numëron të publikuar në rrjetin social “Instagram” 156 postime. Thënë ndryshe, 156 postime janë publikuar në 134 ditë, çka do të thotë se mesatarisht Kryebashkiaku poston për ndjekësit e tij 1 ose 2 herë në ditë.

“Prioritet kryesor i një shoqërie duhet të jetë mbajtja përgjegjëse dhe nën kontroll gjyqësor e politikanëve të cilët duke menaxhuar pushtet dhe financa kanë mundësi edhe të pasurohen e të krijojnë “shtete private”, struktura të infilttruara brenda shtetit të cilat shmangin ligjin dhe interesin publik dhe marrin vendime për interesa okulte” – përfundon Vokshi.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ANALIZA E MEDIAS GJERMANE: I PËRJETSHMI EDI RAMA DHE MALLI I SHQIPTARËVE PËR EUROPËN



Revista gjermane “Blätter für deutsche und internationale Politik”, një botim serioz dhe kritik me fokus në zhvillimet politike evropiane dhe ndërkombëtare, i ka kushtuar një artikull të gjatë Shqipërisë dhe kryeministrit Edi Rama pas fitores së tij të katërt radhazi në zgjedhjet parlamentare të 11 majit. Në këtë analizë, gazetarja gjermane Franziska Tschinderle ndalet tek figura e Ramës si lider dominues në një vend që ende e sheh integrimin evropian si horizontin e vet të vetëm politik.

Artikulli thekson kontrastin mes imazhit pro-evropian që Rama promovon jashtë vendit dhe realitetit të brendshëm, ku pushteti i tij nuk sheh më asnjë kontroll institucional. Përmendet edhe mënyra se si Shqipëria po paraqitet si “laborator” për krizat evropiane – nga ndalimi i TikTok deri te marrëveshja me Giorgia Meloni për kampet e refugjatëve.

Me titullin domethënës “I përjetshmi Edi Rama dhe malli i shqiptarëve për Europën”, artikulli është një vështrim i ftohtë dhe realist mbi kontradiktat e një vendi që nga njëra anë ëndërron Europën, por nga ana tjetër ecën mbi një sistem politik të betonuar dhe të dominuar prej dekadash nga po të njëjtët emra.

Më poshtë shkrimi i plotë “Blätter für deutsche und internationale Politik”

Në një mbrëmje të së premtes, dy ditë para fitores së tij në zgjedhjet parlamentare të 11 majit, Edi Rama mbledhi sërish ekipin e tij në një fushë futboll. Pothuajse e gjithë udhëheqja e Partisë Socialiste të Shqipërisë (PS) ishte e pranishme – ministrat aktualë dhe kandidatë të rinj. Më shumë gra sesa burra folën në skenë, gjë që është e pazakontë për një vend ballkanik. Por edhe diçka tjetër ishte çuditërisht e zakonshme atë mbrëmje në stadium, diçka që shihet gjithnjë e më rrallë në rajon: flamujt e Bashkimit Evropian.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë qenë në pritje të anëtarësimit në BE që nga viti 2003. Me përjashtim të Shqipërisë, të gjitha dolën nga trashëgimia e Jugosllavisë. Pas luftërave të përgjakshme të viteve 1990, Bashkimi Evropian ishte një projekt paqeje joshës për ta. Por dy dekada më vonë, ajo eufori është zëvendësuar me një ndjenjë mungese perspektive. Një kombinim mes mungesës së reformave në rajon, zhvendosjes djathtas në shumë vende të BE-së dhe mungesës së vullnetit politik nga qeveritë evropiane, e ka ngadalësuar procesin në atë masë sa pakkush në Ballkan beson më në anëtarësim.

Vetëm Shqipëria, vend që hapi kapitujt e parë të procesit të anëtarësimit në tetor 2024, po përjeton një ngritje entuziazmi në këtë drejtim. Edi Rama, kryeministër që nga viti 2013, kishte vendosur në postera zgjedhorë premtimin: “Shqipëria në BE deri më

2030. Vetëm me Edin dhe PS-në!”. Reperi i njohur shqiptar Noizy shkroi këngën e fushatës për socialistët: “Bashkë për një qëllim: në Europë!”

Ndërkohë që partitë euroskeptike po rriten në shumë pjesë të BE-së, në Shqipëri ndodh e kundërta. Në vendin me 2.4 milionë banorë, nuk ekziston asnjë parti që mobilizohet kundër anëtarësimit. Kjo lidhet pjesërisht me faktin se gjatë diktaturës komuniste (1944–1991), Shqipëria ishte një nga vendet më të izoluar në botë, e njohur si “Koreja e Veriut e Europës”.

Deputetja socialiste Elisa Spiropali e përmbledhi kështu këtë ide në fjalimin e saj në stadium: “Kemi qenë të izoluar nga Europa për kaq shumë vite. Tani kemi një mundësi unike. Edi Rama është arkitekti i një Shqipërie evropiane.”

Por kritikët e Ramës, ashtu si dhe një pjesë e madhe e opozitës, e shohin ndryshe. Ata e akuzojnë atë për përqendrim të vazhdueshëm të pushtetit gjatë 12 viteve të fundit. Fillimisht në partinë e tij, ku ka qenë figura e padiskutueshme prej vitesh, e më pas në shtet, ku socialistët qeverisin shumicën e bashkive. Rama po fiton gjithnjë e më shumë reputacion për marrjen e vendimeve në mënyrë të njëanshme.

Dy projekte të debatueshme e ilustronjë këtë: kampet për refugjatët italianë dhe ndalimi i TikTok-ut.

Në nëntor 2023, Rama njoftoi papritur se Italia do të ndërtonte kampe pritëse për refugjatët me gomone në veri të Shqipërisë. Një pjesë e madhe e publikut shqiptar – përfshirë opozitën, diplomatët e huaj dhe gazetarët – u befusuan. Marrëveshja thuhet se u arrit gjatë një vizite në pushimet verore të kryeministres italiane Giorgia Meloni në rezidencën bregdetare të Ramës. Miqësia politike mes socialistit Rama dhe post-fashistes Meloni habiti shumë jashtë vendit. Kjo lidhet me një keqkuptim mbi Ramën, i cili shpesh konsiderohet gabimisht si majtist. Por në Shqipëri, ideologjitë

nuk luajnë rol – madje as tek opozita që supozohet si konservatore.

Edhe pse gjykatat italiane e kanë pezulluar vazhdimisht projektin dhe kampet mbetën bosh, Rama përfitoi nga ky bashkëpunim. Ai e di që çështja e migracionit ndikon zgjedhjet në Europën Perëndimore. Me marrëveshjen me Melonin, ai ofrohet si “zgjidhës problemi”. Ndryshe nga presidenti serb Aleksandar Vuçiq, Rama nuk perceptohet si destabilizues në Ballkan, por si një partner i gatshëm për Bashkimin Evropian. Shqipëria, si anëtare e NATO-s, nuk kërkon afrim me Rusinë apo Kinën.

Rasti i dytë është ndalimi i TikTok-ut. Në dhjetor 2024, pas një krimi të dhunshëm në një shkollë, Rama ndaloi aplikacionin e videove të shkurtra. Ashtu si me kampet, Rama e ofron vendin e tij të vogël si një laborator testimi për sfida globale.

Rama kërkoi gjithashtu vëmendjen si mikpritës i liderëve evropianë. Pesë ditë pas zgjedhjeve, më 16 maj, u mbajt në Tiranë Samiti i Komunitetit Politik Evropian, një iniciativë e presidentit francez Emmanuel Macron. Rama ndërtoi një sallë konferencash në sheshin Skënderbej. Krerët e 47 shteteve u mbledhën në një strukturë të përkohshme, me mure të zbukuruara me vizatime të fëmijëve shqiptarë mbi temën e Europës. Diskutimet u përqendruan në luftën në Ukrainë dhe çështjet e sigurisë. Por për Ramën, samiti ishte mbi të gjitha një fitore e brendshme politike. Ndërkohë që opozita protestonte pas kordonëve të policisë për mashtrim elektoral, Rama shfaqej në skenë me liderët e BE-së.

Televizionet shqiptare e shfaqën atë në tapetin e kuq, me atletet e bardha tashmë ikonike, duke i përshëndetur të gjithë individualisht – madje duke u përkulur teatralisht para Melonit. “Është e vërtetë që jam më i gjati mes tyre, por udhëheq një vend ndër më të vegjlit. Për ne, të jemi mikpritës të këtij samiti është një nder i madh,” deklaroi Rama para takimit.

Por gjithë kjo vëmendje ndërkombëtare largon vëmendjen nga realiteti në Shqipëri, ku Rama po grumbullon gjithnjë e më shumë pushtet. Si ndalimi i TikTok-ut, ashtu edhe marrëveshja me Italinë, u realizuan me një mungesë transparence dhe shpejtësi të paprecedentë, e pamundur në një demokraci të konsoliduar. Partia Socialiste e bën këtë sepse qeveris me shumicë absolute që nga viti 2017.

Rama nuk do të ketë nevojë për partner koalicioni as për katër vitet e ardhshme. Socialistët morën 52 për qind të votave.

Ndryshe nga Kosova fqinje, ku nacionalisti i majtë Albin Kurti fitoi me shumicë të thellë në 2021, Shqipëria nuk ka përjetuar kurrë një ndërrim real të elitave. Që nga rënia e komunizmit, të njëjtat parti përballen: PS e Ramës dhe PD e Sali Berishës, i cili ka qenë në pushtet nga 2005 në 2013.

Berisha, një ish-kardiolog gjatë diktaturës, ka ndikuar politikën shqiptare për 35 vite. Ai ishte presidenti i parë jo-komunist pas vitit 1991 dhe ende përfiton nga imazhi si “çlirimtar”. Së fundmi, ai ka përjetuar rënie dhe ringritje të forta.

Në vitin 2021, ai u sanksionua nga SHBA për korrupsion. Pas një lufte për pushtet me Lulzim Bashën, u rikthye në krye të PD-së. Më pas u vendos në arrest shtëpie. SPAK – Prokuroria e Posaçme – ngriti akuza për korrupsion. Për fushatën, Berisha kontrakttoi Chris LaCivita, ish-menaxherin e fushatës së Trump. Ai shpresonte se republikanët do të hiqnin sanksionet dhe përdori retorikën e Trump: drejtësia është e kapur dhe po e përmendek pa arsye.

Në realitet, SPAK nuk kursen askënd. Ka arrestuar figura pranë Ramës. Përveç ish-ministrave të Mjedisit dhe Shëndetësisë, në shënjestër ka rënë edhe Erion Veliaj, kryebashkiaku i Tiranës, i konsideruar si pasues i mundshëm i Ramës.

Megjithë skandalet, Berisha dhe

Rama mbeten figurat dominante. Por disa zhvillime e bënë këtë fushatë interesante.

Kush e kontrollon pushtetin e Ramës?

Së pari, në zgjedhje morën pjesë parti të reja. Të rinj nga diaspora kandiduan në qarqet e tyre. Disa parti u formuan nga përçarjet në Partinë Demokratike. Agron Shehaj fitoi 2 mandate me partinë “Mundësia”; “Lëvizja Bashkë” fitoi një mandat, po ashtu edhe “Shqipëria Bëhet”, që doli nga një lëvizje qytetare dhe çoi disa çështje në SPAK.

Së dyti, për herë të parë diaspora votoi me postë. 250 mijë u regjistruan, 195 mijë votuan.

Së treti, ndryshimet në ligjin elektoral bënë që partitë të mos caktonin më të gjithë renditjen e kandidatëve. Dy të tretat e listave mbetën të hapura.

Por asnjë nga këto nuk solli ndryshim pushteti. Partia Socialiste fitoi madje edhe në diasporë me 60 për qind. Dominimi i PS dhe PD lidhet edhe me sistemin elektoral kompleks që dëmton partitë e vogla. Shteti është punëdhënësi më i madh dhe shpesh nuk ndahet nga interesi partiak. OSBE kritikoi “avantazhin e pajustificuar” të PS, duke përmendur presione mbi punonjësit publikë. Problemi i sistemit shqiptar është se me çdo ndërrim pushteti ndryshon edhe administrata. Gara nuk është për programe më të mira, por për burime shtetërore. Rama nuk është më shumë socialist, se sa Berisha është konservator.

Emocione për diasporën

Rama përdori një ëndërr të vjetër të shqiptarëve: anëtarësimin në Europë. Pas rënies së komunizmit, shqiptarët përjetuan diskriminim, sidomos në Greqi. Rama përfaqëson një vetëbesim të ri kombëtar. Me ritjen e turizmit, perceptimi për Shqipërinë është përmirësuar. Prandaj nuk ka rëndësi nëse anëtarësimi deri më 2030 është i përealizueshëm – sidomos nëse akuzat për abuzim me fondet e BE-së provohen, si dhe dyshimet për pastrim parash nga trafikë i kokainës në ndërrim.

Për shkak të servilizmit të Ramës ndaj Perëndimit, këto pyetje shpesh injorohen nga Bashkimi Evropian. Shqipëria ka bërë përparim, veçanërisht në drejtësi, por pozicioni i saj mes kandidatëve për anëtarësim në BE ndikohet edhe nga bllokimet politike në vendet fqinje. Për të hyrë në BE, Rama do të duhet të gëlltisë disa pilula të hidhura – ndoshta edhe hetime ndaj njerëzve më të afërt të tij nga një prokurori speciale e fuqishme./ Blätter für deutsche und internationale Politik

BEQIR SINA

Mijëra shqiptarë marshuan sot në rrugët e Nju Jorkut (Manhattan-it), si pjesë e paradës dedikuar komunitetit shqiptar në SHBA. Shqiptarët me këtë rast manifestuan kulturën dhe identitetin kombëtar simbolet dhe me flamuj kuq e zi, valle dhe muzikë shqiptare, nga Shqipëria, Kosova dhe trevat shqiptare.

Në ndërkohë, festimet kulmuan me një parakalim dhe aktivitete kulturore e artistike, këngë e valle shqiptare në segmentin e rrugëve Central Park West dhe 81 St. në një atmosferë imponante bashkimi dhe krenarie shqiptare.

Në zemër të Manhattan-it, mijëra shqiptarë nga të gjitha trevat dhe diaspora, u mbledhën këtë të shtunë për t'iu bashkuar paradës, festës shqiptare në New York.

Ngjarja, e organizuar nga "Albanian Roots", me president zotin Marko Kepi, shënon një nga momentet më të rëndësishme të bashkimit kulturor të komunitetit shqiptar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke sjellë gjallëri, krenari dhe emocion në rrugët e qytetit të Nju Jorkut.

Parada e nisur paraditen e së shtunës (21 qershor) me orën lokale 11AM nga blloqet e Central Park West, për të vazhduar përgjatë rrugës së 81th St. deri në 68th Street, ka tërhequr me këtë rast edhe vëmendjen e qytetarëve të shumtë amerikanë (njujorkezve) si dhe të turistëve të huaj, që këto ditë po vizitojnë Nju Jorkun, ku po zhvillohen edhe ndeshjet e kupës së botës për klube "2025 – FIFA Club World Cup".

Pjesëmarrësit e kësaj parade shumica e tyre nxënësit e shkollave elementare, të rinj e të reja shqiptar, madje edhe nga ata të lindur në Amerikë, parakaluan në rrugët e qytetit të Nju Jorkut, duke vallëzuar e kënduar ndërsa mbanin flamuj kuqezi, veshje tradicionale, bluza të kuqe me shqiponjën, flamujt dhe simbolet e UÇK-së, dhe pankarta me mesazhe, që pasqyronin lidhjen e fortë me rrënjët shqiptare.

Në krye të paradës ishte vendosur një banderolë e madhe ku ishte shkruar "Pa Kosovë e Çamëri nuk ka Shqipëri".

PARADA SHQIPTARE NË NEW YORK: NJË FESTË E IDENTITETIT DHE KRENARISË KOMBËTARE



Në këtë paradë karrocieritë e tërhequra nga automjete ishin të veshura me logot e shoqatave dhe organizatave, kurse në të dy anët e tyre kishte postera me pamje nga vend/origjina e tyre.

Grupet muzikore sipas krahinave, me valltarë popullorë dhe këngëtarë të njohura të komunitetit për më shumë se tre orë interpretuan gjatë gjithë marshimit kuq e zi, duke e kthyer paradën shqiptare në një festë të madhe dhe të bukur shqiptare në zemër të Nju Jorkut.

Parada shqiptare në New York, për herë të parë mbahet me njohje zyrtare nga Bashkia e qytetit, e cila me këtë rast në rezidencën e kryebashkiakut të Nju Jorkut, para fillimit të paradës, priti zyrtarisht disa lider të komunitetit shqiptar, për të deklaruar të hapur paradën shqiptare dhe nderuar ata me nga një Proklamata.

Kryebashkiaku i New York-ut, Eric Adams, i cili priti përfaqësues të komunitetit shqiptar në rezidencën e tij, në një fjalë rasti ka vlerësuar kontributin e diasporës shqiptare në jetën qytetare dhe kulturore të qytetit.

Ai theksoi se diversiteti është një nga pikat më të forta të New York-ut, dhe se komuniteti shqiptar është shembull për këtë frymë bashkëjetese.

"Çfarë dite. Çfarë dite e bukur kjo",

tha në fillim të fjalës së tij zoti Adams, dhe vazhdoi kur ju mendoni, për vëllezërit dhe motrat tuaj nga Shqipëria, nga Kosova, nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut: "Kjo, do të thotë shumë për ne të gjithë që jemi këtu në Gracie Mansion. Parada tuaj, është një paradë, që do të thotë shumë...., një paradë, që është simbolike në këtë vend, si një mënyrë për të treguar se ju jeni pjesë e gjithçkaje që ka Nju Jorku sot."

Në vazhdim të fjalës së tij kryebashkiaku i Nju Jorkut, tha se një paradë, është simbolike në këtë vend si i yni, një mënyrë për të deklaruar se komunitetet janë pjesë e gjithçkaje në të cilën ne besojmë.

"Dhe, bukuria e kësaj parade është se kur ju marshoni në njërin nga rrugët tona kryesore, në NYC, tha ai tregoni dhe shfaqni flamurin tuaj, kuq e zi, dhe ato simbole të krenarisë tuaj që keni çka do të thotë se përse e keni lënë vendin tuaj për t'u adoptuar, me këtë vend Amerikën. Dhe ju jeni në gjendje t'i keni të dyja. Dhe, të mendoni e punoni, kontriboni për të dyja, dhe të përfaqësoni vet/veten".

Në ndërkohë, që shqiptarët po mendoheshin se duhet të falënderonin kryetarin e Bashkisë së qytetit të Nju Jorkut, ai tha se:

Jo! ne duhet t'ju falënderojmë Ju, Mbas shqiptarët në këtë vend sjellin

këtu besim, Ju sillni këtu kulturën tuaj, Ju sillni këtu etikën tuaj të punës. Ju sillni këtu sigurinë publike. Shqiptaro-amerikanët, janë pjesëtar të NYPD, që, jo vetëm nderojnë, zbukurojnë uniformën e policisë, por zbukurojnë edhe atë simbolin tuaj kuq e zi."

Në fund të fjalës së tij kryebashkiaku i qytetit të Nju Jorkut, veçanërisht falënderoj të gjithë ata shqiptar që shërbejnë në uniformat blu të NYPD dhe që ishin për të festuar së bashku paradën shqiptare."

Kryetari i Bashkisë Eric Adams po ashtu tha se u deshën 109 kryetarë bashkie në NYC, të kalonin dhe të vinte i 110 që New York City, të kuptonte se duhet të kishim edhe një Paradë të Ditës së Shqiptarëve, këtu në qytetin e Nju Jorkut.

"Kur më pyetën nëse mund të kenë shqiptarët një paradë? Unë thashë: Po! Dhe, ne do ta bëjmë të ndodhë dhe ju sigurojë që do të jetë një nga paradat më të mira që do të shihni, tha ai duke deklaruar se 200,000 shqiptarë jetojnë në New York City, janë ata që do të tregojnë forcën e tyre."

Më tej duke folur për numrin e madh të shqiptarëve dhe kontributin e tyre, në qytet, zoti Adams, tha se "Numri më i madh i shqiptarëve në këtë vend është pikërisht këtu në New York City, nga "Shqipëria e vogël" në

Bronx, deri te "Shqipëria e vogël" në Kuins, Bruklin dhe Staten Island. Shqiptar, këta që janë rritur me qytetin dhe që kanë pasur një pikëmbështetje të fortë, një forcë politike e cila është e pashembullt e juaja," tha ai.

Pas përfundimit të paradës, festimet vijuan me një koncert dhe aktivitete kulturore në zonën e një lokali në West 72nd Street.

Marko Kepi, president i organizatës Rrënjët Shqiptare, i cili e organizon këtë paradë për më shumë se 15 vjet, në një status në rrjetin social WhatsApp shkruajti: Faleminderit nga thellësia e zemrës sime për gjithçka që keni bërë për ta bërë këtë paradë një sukses. Në një kohë kaq të shkurtër, puna juaj e palodhur, uniteti dhe dashuria juaj për kulturën tonë e bënë këtë ëndërr realitet.

"Kjo paradë nuk ishte thjesht një ngjarje, por ishte histori në krijim e sipër dhe nuk do të kishte ndodhur pa ju. Jam krenar dhe mirënjohës për të gjithë ju." thotë ai.

Në emër të organizatorit Kepi po ashtu ka shprehur edhe një falënderim të veçanta për aktivistin Sal Rusin, për të cilin thotë ai gjithmonë e merr telefonin kur telefonojmë dhe falënderim për përpjekjet e tij për të na miratuar lejen zyrtare nga bashkia e NYC, si dhe për Mark Gjonajn dhe ekipin e tij të mrekullueshëm që punuan pa ndërprerje për 11 ditë rresht, për t'u siguruar që të arrinim me sukses sot. Nga mbledhja e fondeve deri te gjithëcka tjetër."

Ai thotë se kjo paradë është e jona për ta mbajtur dhe për t'ia kaluar brezave të ardhshëm, shansi ynë një herë në vit për t'i treguar botës më të mirën e Shqipërisë!

Parada shqiptare në New York, është më shumë se një ngjarje festive, ajo është një manifestim krenarie, uniteti dhe trashëgimie që kalon brezat dhe kontinentet, dhe organizohet për më shumë se 15 vjet nga organizata "Rrënjët Shqiptare" me president Marko Kepin e cila e ka dhe ekskluzivitetin e saj.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



POROSISNI BANNER PËR BIZNESIN TUAJ



**PVC BANNERS
MESH BANNERS
PREMIUM ROLLER
PULL UP ROLLER**



Na kontaktoni:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

MUJË BUÇPAPAJ

“Në një vend ku historia shkruhet ende nga fitimtarët e së djeshmes, ky dokumentar rikthen zërat e humbur – jo për hakmarrje, por për kujtesë. Dokumentari ‘Spaç 1973 – Martirët e Lirisë’, i autorëve Besim Ndrejoni dhe Dash Kaloçi, është një akt rebelimi kulturor kundër harresës”.

Më 17 qershor 2025, në kinema “Millenium” në Tiranë, u prezantua dokumentari tronditës, “Spaç 1973 – Martirët e Lirisë”, i realizuar nga dr. Besim Ndrejoni dhe Dashnor Kaloçi. Kjo premierë nuk ishte thjesht një film dokumentar, por një dëshmi për një plagë të hapur, një dritë për të vështruar rishitazhin e komunizmit shqiptar të shekullit XX, një klithmë e atyre që vdiqën, por edhe të të mbijetuarve kundër heshtjes që e rrethon ende atë ferr. Ky dokumentar është një akt rebelimi kulturor kundër harresës. Ai ngrihet si një monument për ata që nuk patën varr, por që mbeten të gjallë në ndërgjegjen tonë, nëse nuk e kemi shitur edhe atë.

2. Në maj të vitit 1973, në kampin e Spaçit – një nga vendet më të errëta të diktaturës shqiptare – ndodhi një akt i jashtëzakonshëm: të burgosurit politikë, edhe pse të rrahur, të keqtrajtuar deri vdekje, të zhveshur nga çdo të drejtë njerëzore, të mbikëqyruar ditë e natë, ngritën krye. Flamuri kombëtar pa simbolin komunist, u ngrit mbi telat me gjemba. Për tri ditë rresht, fjala “liri” guxoi të tingëllonte atje ku nuk lejohej as frymëmarrja. Shteti ndërhyri mizorisht, në një betejë të parabarabartë me të burgosurit politikë.



Revolta përfundoi me gjak. Katër burra u pushkatuan. Të tjerë u dënuan me burgime të reja përmes procesesh farsë. Por, historia qëndroi. Dhe ky dokumentar na e kujton atë jo si datë kalendari, por si moment për të rikthyer dinjitetin njerëzor.

3. Dokumentari “Spaç 1973 – Martirët e Lirisë” është ndërtuar mbi tri shtylla të forta: kujtesën e gjallë, dokumentimin historik dhe ndërgjegjen njerëzore. Skenari i thelluar dhe i bazuar në arkiva të Dashnor Kaloçit, rrefimet rrëqethëse të të mbijetuarve dhe montazhi i ngjeshur emocional i Gjergj Panos e bëjnë këtë film një

SPAÇ 1973 – MARTIRËT E LIRISË”, REBELIMI KULTUROR VEPRA KUNDËR HARRESËS

të ndryshme e kthen dokumentarin në një akt të rrallë dhe të guximshëm ballafaqimi me të shkuarën.

Në një vend ku historia shkruhet ende nga fitimtarët e së djeshmes, ky dokumentar rikthen zërat e humbur jo për hakmarrje, por për kujtesë.

5. Në fjalën e tij gjatë premierës, dr. Besim Ndrejoni e quajti Spaçin “Aushvici shqiptar”. Dhe ka të drejtë. Por, ndryshe nga Evropa që ndërtoi muze, kërkoi falje, hapi dosje dhe ndërtoi edukim mbi të kaluarën, Shqipëria sot akoma ngurron të njohë krimin. Akoma mban të klasifikuara dosje. Akoma nuk përfshin në kurrikulën e shkollave krimet e diktaturës komuniste siç ka bërë SHBA. Shqipëria akoma ngatërron drejtësinë me heshtjen. Ky dokumentar i autorit dr. Besim Ndrejoni, është më shumë se një realizim artistik – është një akt drejtësie përmes kujtesës. Ai i kujton shoqërisë shqiptare se pa ballafaqim të ndershëm me të kaluarën, çdo demokraci mbetet e përkohshme.

6. Për mua, ky dokumentar është më shumë se një histori kombëtare – është një plagë personale. Në Spaç ka vuajtur daja im Isuf Meshi, njëri ndër qindra të burgosur të ndërgjegjes, një ndër ata që diktatura nuk arriti t’i përlulë. Nga fisi im, Buçpapaj të Tropojës, kam pasur të afërm të tjerë të burgosur, që mbeten për vite me radhë të harruar, të nëpërkëmbur në

Spaç, por të pathyer. Duke qenë vetë një ndër anëtarët e lëvizjes studentore të dhjetorit 1990, që solli rrëzimin e diktaturës dhe themelimin e Partisë Demokratike, e kam jetuar personalisht tranzicionin shqiptar mes idealit dhe gjakut, mes shpresës dhe zhgënjimit. Dhe e ndiej më shumë se kurrë se ky dokumentar është një thirrje jo vetëm për të kujtuar, por për të vepruar – për të institucionalizuar të vërtetën dhe për të mos lejuar që Shqipëria të harrojë, ku ka rënë dhe kush i vuri këmbën në fyt.

7. Në vende si Polonia apo Çekia etj., dokumentarët për krimet e komunizmit janë pjesë e kurrikulës arsimore. Të mbijetuarit shkojnë në shkolla dhe flasin për atë që përjetuan. Pushteti nuk i ka harruar, por i ka kthyer në gurë themeli të vetëdijes kombëtare. Edhe ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë. Spaçi duhet të shpallet muze kombëtar, të gjitha dosjet e diktaturës duhet të deklasifikohen dhe arsimi duhet të përfshijë historinë e vërtetë të komunizmit.

8. “Spaç 1973 – Martirët e Lirisë” është një dokumentar që nuk përfundon me mbarimin e filmit. Ai nis pikërisht atëherë, në ndërgjegjen e secilit prej nesh. Nëse nuk e kujtojmë Spaçin, nëse nuk mësojmë prej tij, nëse nuk u japim zë dëshmorëve të lirisë, atëherë nuk jemi të denjë për lirinë që kemi.

LUTFI DERVISHI

BOMBA BËRTHAMORE E SHQIPËRISË!

Nëse mendojmë se problemet që kemi janë korrupsioni, papunësia, zgjedhjet e kontestuara, uji i (pa)pijshëm, mungesa e drejtësisë apo largimi i trurit, po injorojmë dramën që po gërryen themelet e vendit: plakjen e popullsisë.

Sipas të dhënave më të fundit, vendi ka hyrë zyrtarisht në listën e 11 vendeve më të plakura të Europës. Moshë mesatare sot është 44.3 vjeç, ndërkohë që në 2010 ishte 31.9. Ritmi i moshimit është i jashtëzakonshëm: 12.4 vite në vetëm 14 vjet, katër herë më shumë se mesatarja e vendeve të BE-së.

Në një kontinent që vetë po lufton prej dekadash me plakjen, Shqipëria nuk është se vetëm po plakët... por po zbrazet. Nuk po zbrazët vetiu. Presidenti francez Charles de Gaulle thoshte dikur: "Demografia bën historinë, dhe jo e kundërta." E nëse historia është udhërrëfyese ynë, atëherë ne jemi duke ndjekur një kurs që s'na çon drejt BE-së, por drejt një zbrazëtie me pasoja fatale. Një shtëpi që nuk merr frymë brehet.

Kush do të paguajë pensionet? Kush do të mbajë gjallë sistemin shëndetësor? Kush do të punojë tokën, të hapë biznese, të mbajë gjallë gjuhën, qytetet, lagjet? Kush do të votojë? Kush do të sigurojë të ardhmen, vijimësinë? Dhe më e rëndësishmja: kush do të na përfaqësojë?

Nëse demokracia funksionon mbi parimin e përfaqësimit, atëherë në mungesë të rinjve, do të kemi një sistem që punon për të moshuarit. Shenjat janë të qarta: në fushatë premtimi kryesor ishte rritja e pensioneve.

Jemi kthyer në një vend ku shumica e brezit të pensionistëve vendos për të ardhmen e brezit të ri.

Në vend të çerdheve, kopshteve e shkollave, do të flasim gjithnjë e më shumë për ndertimin e azileve. Dhe do të përfundojmë shumë shpejt në gerontokraci (pushteti i pleqve) Kjo krizë është sociale, ekonomike dhe politike. Por çuditërisht, kriza nuk artikullohet. Asnjë sociolog, asnjë demograf, asnjë profesor i universitetit nuk po e ngre zërin siç duhet. Min-



istrinë heshtin. Akademia e Shkencave hesht. Edhe biznesi, që do të duhej të ishte në alarm për mungesën e fuqisë punëtore, po sillt sikur gjithçka do të zgjidhet me ndonjë tender a PPP për të sjellë emigrantë nga Azia. Kjo nuk është thjesht mungesë vëmendjeje, është tentativë vetëvrasje kolektive. Rastësi?

Nëse plakja është e pandalshme, braktisja mund të ndalet. Në vend të një politike e propagande të bazuar në projeksione dhe llogari statistikore,

për numrin e turistëve që rritet krahasuar me 2013, kemi nevojë për një shkundje shoqërore dhe politike.

Një pakt kombëtar për ripërtëritje demografike, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve; shtetit, shoqërisë civile, universiteteve dhe biznesit i shoqëruar me politika sociale për rikthimin e emigrantëve të rinj dhe për stimulim të lindshmërisë do të ishte një fillim i mirë. Politikat e Hungarisë në këtë drejtim (apo çdo vendi që ka sukses në këtë fushë) duhen qëmatur e zbatuar pa humbur kohë. Bonusi i be-

veve duket se nuk dha rezultatet që priteshin.

Modeli i zhvillimit: gjithë Shqipëria në Tiranë po zbrazet qytete e fshatra. Është prishur ekuilibri demografik i vendit. Është e domosdoshme rivedosja e dinjitetit të jetës në vend, në qytete dhe sidomos në fshat. Kjo nënkupton zhvillim të qëndrueshëm dhe jo fasada dhe shifra me milionë turistë që vizitojnë vendin.

Nëse vendi vijon të plakët me këtë ritëm dhe me këtë heshtje, atëherë nuk kemi më së çfarë të ardhme të planifikojmë. Viti 2030 rezikon të na gjejë më bastun "drejt BE", nëse ajo do të jetë ende në këmbë.

Sot nuk na mungojnë shifrat. Shifrat po ulërasin, por mungon zëri.

Është paradoks që një vendi që shurdhohet nga propaganda, i mungon klithma për jetën.

Ndoshta për herë të parë pas shumë dekadash, armiku më i rrezikshëm i Shqipërisë nuk është korrupsioni, por ora biologjike.

Tre dekada kryefjala ka qenë "demokracia", tani është: "demografia", nesër do të jetë afiksia?

PSE KËTO ISHIN VOTIMET MË TË MIRA QË MUND TË KISHIM

ANDI BUSHATI

Materilalet filmike për manipulimin e votës që po publikon me një frekuencë këmbëngulëse opozita, jo vetëm që i kanë qesharakëzuar në maksimum këto votime, por ato kanë ngritur edhe një dyshim që po dëgjohehet gjithnjë e më shpesh: Mos vallë jemi rikthyer edhe tek vjedhja në kuti?

Ky fenomen që ishte zhdukur nga garat elektorale shqiptare që në fillim të viteve 2000, periudhë prej së cilës manipulimet u bënë më sofistikuara, duke i dhuruar ditëve të zgjedhjeve togfjalëshin “të qeta dhe pa probleme”, duket se është rishfaqur. Ai ka rihapur debatin nëse sfidat zgjedhore të epokës Rama paracaktohen shumë kohë përpara datës kur njerëzit hedhin fletën në kuti, apo në të kundërt, hilet vijojnë deri në momentin e fundit.

Kjo përplasje e re, e prodhuar nga ajo që po shohim me sytë tanë, i është mbivendosur edhe shumë dilemave të tjera që po shkatojnë polemika, pothuajse në çdo studio televizive, pas 11 majit. Sa ndikoi në këtë proces prezenca e grupeve kriminale?

Po paraja e tyre e pisët që po betonizohet nga Tirana në Dhërmi? Sa rol luajtën aty mediat e kapura? Sa influencë pati fakti se opozita hyri në betejë me një sërë udhëheqësish të saj të persekutuar politikisht nga “drejtësia”?

Cila qe pesha reale e fragmentarizimit të saj, që u arrit, si falë lobingjeve alla McGonigal, të financuara me paratë e korrupsionit, po aq dhe falë gjykatave që qenë të vetmet që nuk i shikonin Bashën dhe Alibeajn si mbretër lakuriq dhe vijonin të mabanin të asfiksuar PD-në?

Në fakt, një gabim që bën shumica e këtyre debatuesve, madje mes tyre edhe eksponentë të opozitës, është se dikush e vë theksin tek njëri fenomen, e dikush tek një tjetër manipulim, duke pamundësuar që të shikohet se gjithçka që ka ndodhur është pjesë e së njëjtës tërësi. 11 maji sanksionoi përfundimisht se Rama dhe Rilindja nuk përfitojnë nga të çarat e sistemit, se ata nuk bëjnë hile, apo manipulime duke ia hedhur atij, por ata thjeshtë e kanë shkallmuar atë.

Këto votime vulosën se Shqipëria nuk



është më një demokraci dhe prandaj “zënkat” se cilët elementë të paligjshëm luajtën rol në rezultat janë thjesht budallallëqe naive.

“Nuk konkludohet kështu, me një të rënë të Lapsit”, mund të thotë dikush që s’do ti shohë faktet dhe përton ta vërë trurin në punë.

Për të gjithë ata që ende se besojnë që këto votime që nuk u zhvilluan brenda një sistemi demokratik ka disa pyetje të tjera që mund të renditen për t’i kthjelluar.

Ku ndodh në një të tillë (le ta gjejmë qoftë dhe një të vetëm) që partia në pushtet të marrë më shumë vota edhe se kur ka qenë në opozitë (2009-2013) edhe se kur ishte në mandatet e para qeverisëse? (2017-2021)? Ku ndodh që në krye të jetë një njeri i vetëm? (Si alibi Rama përmend rastin

gjerman të Merkelit apo atë holandez të Rytes, por ata kanë qeverisur të kontrolluar nga koalicionet dhe jo si të vetëm në timon)?

Ku ndodh që, sa më shumë të vërtetohen vjedhjet, aq më lart të shkojnë përqindjet? Ku ka një vend tjetër që konsiderohet demokratik me liderin e opozitës përmbi një vit të izoluar, me kreun e partisë së dytë më të madhe në burg, me shefin e minoritetit më të rëndësishëm, që i rrëmbejnë fitoren e Himarës me gjykatë?

Ku ndodh që SPAK-u dhe policia të kapin hajdutë votash vetëm nga opozitat, duke këmbëngulur në tezën absurde se këtu vjedhin ata që në fund humbasin? Ku ndodh që të gjitha mediat e mëdha (mbi 90% e audiencës) të mos zhvillojnë asnjë debat, se si jemi qeverisur në katër vite, nga frika se i prishin punë atij që i mban pronarët e tyre me para?

Boll të hapësh pak sytë dhe e kupton fare lehtë se këto ndodhin në regjime që i përafrohen modelit putinian, ku cari i Kremlinit, që fitoi herën e parë me pak më shumë se 50% garën e fundit u ngjit në 88%.

Pra dhe fabula shqiptare është tejet e thjeshtë: ne nuk kemi zgjedhje të lira, nuk kemi drejtësi dhe media të pavarura pasi nuk jetojmë më në demokraci.

Të bësh sikur se kupton këtë dhe të analizosh ato që ndodhin sot me klishtë e sistemit të deri djeshëm do të thotë të marësh përsipër një rol sa absurd aq edhe qesharak.

Më e lehtë do të ishte të pranoje se tashmë kemi hyrë në një periudhë autokratike, duke ndryshuar bashkë me dorëzimin përballë këtij realiteti edhe mënyrën e të menduarit të gjërave. Në

këtë qasje të re mund të gjenden edhe “anë pozitive”. Vërtet ka votime dhe jo zgjedhje, po sërish opozita merr gjysëm milioni vota. Vërtet nuk ka garë, po parti të reja futen në parlament. Vërtet nuk ka media të lira, ama ka individë të cilëve u lejohet të shfryjnë publikisht në studio televizive, ndonëse pa asnjë efekt. Vërtet nuk ka SPAK dhe gjykata të pavarura, ama ndonjë hajdut i parave publike vazhdon e shkon në burg. Pra ka ende arsye për t’u gëzuar, sepse gjërat mund të qenë edhe shumë më keq, duke i zhdukur një nga një edhe këto iluzione të vogla. Prandaj, në këtë kuptim, 11 maji ishte pjella më e mirë që mund të dilte nga një bark që ka përfunduar të jetë demokratik. Pastaj, pasi kemi mbledhur mendjen për këtë, jemi të lirë të diskutojmë pa frikë nëse vota vidhet para se të vijë tek kutia, apo procesi vijon njësoj deri në fund.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545





Dotech
website 

**AKOMA NUK KENI NJË
WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ ?**

**Akoma nuk jeni
rregjistruar në Google?**

**Për çdo konsultim mund të
vini në çdo kohë në zyrat tona**

NA KONTAKTONI

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**

- **Web Design**
- **Logo**
- **Business Cards**
- **Banners**



**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**

FATOS LUBONJA

REFLEKSION MBI PËRGJUNJEN E RAMËS PARA MELONIT

Skena e përgjnjjes së kryeministrit shqiptar Edi Rama në tapetin e kuq, kur po vinte ta takonte kryeministrja italiane Meloni me rastin e Samitit evropian u bë virale dhe u komentua shumë në Itali.


Në një nga debatet, ku mernte pjesë edhe ish-kryeministri italian Mateo Renzi, një profesororeshë e historisë e komentoj përgjnjjen e Ramës duke iu referuar një zakoni mesjetar të raportit të mbretit me vasalët e tij. Sipas këtij zakoni, vasali, kur i vinte mbreti, duhej të qëndronte i përgjnjtur (ndërkohë që të gjithë vartësit e tij duhet të qëndronin barkas) deri në momentin kur mbreti bënte shenjën që të ngriheshin. Kështu ndodhi edhe në këtë rast – tha ajo, – kryeministri shqiptar u ngrit kur i tha Meloni “basta”. Pastaj, duke qeshur me anakronizmin e kësaj skene, shtoi se një amerikan do ta merrte këtë skenë edhe si një propozim martesë.

Ndërkaq, Mateo Renzi e quajti “paliaciatta” (palaçollëk), por me komentimin e tij tregoi se nuk e kishte hallin tek vasali, por tek mbretëresha që kishte bërë, sipas tij, një “dhuratë” të gabuar sepse me investimin në Gjadër dhe në Lezhë kishte çuar më 800 milionë euro nga paratë e taksapaguesit italian çka, gjithë sipas tij, e justifikonte edhe përgjnjjen e vasalit.

Ajo që ra më në sy është se në Shqipëri nuk pati ndonjë reagim kushedi çfarë ndaj sjelljes së Ramës. Jo vetëm, por kjo skenë u eklipsua nga samiti, i cili u përshëndet si këndej edhe andej kufirit nga shumë shqiptarë me një lloj krenarie kombëtare sepse Shqipëria, sipas tyre, solli tek sheshi “Skënderbej” kryeministrat e të gjitha vendeve evropiane, pa u ndalur fare në atë se kishim të bënim me një “samit-washing” d.m.th. një shpëlarje me fytyrat e kryeministrave evropianë të fytyrës së nxirë të regjimit nga masakra e sapokryer elektorale.

Por s’është hera e parë që shqiptarët nuk reagojnë për akte të tilla, ku sjellja prej vasali e Ramës e kombinuar me nevojën e tij të parezistueshme për t’u dukur, edhe duke bërë gaztorin e oborrit, mbështillet me krenari kombëtare. Heshnje të madhe pati edhe kur iu dha toka italianëve në Lezhë dhe në Gjadër për të sjellë emigrantët.

Përveç një grushti militantësh e gazetarësh, shumica e trajtoi si një gjë normale, madje edhe me mburrje, si shenjë e mikpritjes sonë tradicionale apo të dashurisë sonë historike ndaj Italisë. Po kështu nuk reagan shqiptarët edhe ku i dha



dhëndrit të Trumpit 48 hektarë të ishullit të Sazanit, madje edhe opozita e trajtoi këtë si biznes normal.

Po nga na buron kjo ndjenjë “normaliteti” ndaj sjelljes për të cilat të tjerët na qeshin, madje edhe përçmojnë?

Sipas meje, kjo shpjegohet me atë se ne e kemi të rrënjësor thellë në ndërgjegjen tonë kolektive mendësinë e banorit të një vasallëku, që krenohet kur i vjen mbreti në shtëpi. E kemi që prej atyre kohëve të para kur kjo ka qenë normale.

Edhe heroin tonë kombëtar vasal të mbretit të Napolit e kemi pasur. E kemi trashëgim edhe prej Perandorisë Osmane kur sundimtarët e vegjël të krahinave tona – ata që quheshin “ajanë” – kishin një raport vasaliteti me Portën e Lartë që, me dy fjalë, konsistonte në një marrëveshje sipas së cilës, ajani duhet t’i çonte Sulltanit ushtarë për luftërat që bënte perandoria dhe si shpërblim ky e linte të sundonte sipas qejfit, duke mbyllur edhe një sy për grabitjet e keqtrajtimet që i bënte popullsisë së vet.

Vetëm kur ajani me ambicjet dhe zullumet e tij bëhej tejet shqetësues për Portën e Lartë, atëherë vendosej t’i hiqej pushteti. Rastet më të shquara janë ai i Ali pashë Tepelenës dhe Kara Mahmut pashë Bushatllit.

Vështruar nga paralelizmi historik që bëra, interpretimi i Renzit më duket i mangët, sepse përfitimi i vasalit dhe mbretit në marrëveshjen Rama-

Meloni ka qenë reciprok. Meloni, për përfitimet e veta të lidhura me retorikat e veta elektorale kundër emigracionit, mori një copë tokë shqiptare, që kurrkush nuk do t’ia kishte dhënë sot në botë, kurse “dhurata” që i ka bërë e i bën ajo Ramës nuk janë 800 milionë, por legjitimiteti dhe mbështetja që i jep duke mbyllur të dy sytë për çfarë bën ky në vendin e tij.

Mjaft të kujtosh britmat e saj kundër emisionit “Report” të RAI 3: “A e patë çfarë bënë?! E nxorën Shqipërinë sikur të ishte një narkoshtet.

Duhet t’i kërkojmë ndjesë Edi Ramës”. Por ndoshta Renzit nuk i pëlqen t’i flasin për vasalitet, siç bëri profesororesha italiane, pasi, për hir të së vërtetës edhe në Itali përdoret me sarkazëm termi “vasal”, kur flitet për varësinë nga SHBA, duke përmendur edhe politikanë si Renzi, i cili, kur kërkoi të ndryshonte Kushtetutën për të marrë më shumë pushtet, organizoi një vizitë në Washington duke marrë me vete edhe një aktor të njohur, çmimin “Oscar” Roberto Benigni.

Por ama rezultati i referendumit flet

shumë për ndryshimin që ka sjellë koha andej Adriatikut në raport me këtë Adriatikut. Sepse, megjithëse perandori Obama u shpreh pas takimit në favor të reformës që donte Renzi, mbi 60% e italianëve votuan kundër dhe e detyruan të dorëhiqej.

Është një ndryshim ky jo i vogël, që tregon se andej Adriatikut nuk mund të pranojnë me krenari vasali çdo vendim që merr Porta e Lartë e Washingtonit, siç bëjmë ne që deklarojmë se as nuk duhet të vihen në diskutim vendimet që merren atje për ne.

Po e përdor kaq shumë fjalën “ne”, pasi ajo që dua të them është se në këtë histori problemi nuk është thjesht Edi Rama.

Ai nuk do të guxonte kurrsesi t’i bënte këto përgjnjje sikur të mos mendonte se ne kemi mbetur një popull që shtrihet barkas kur i vjen mbreti për vizitë. Ai (si dhe sivëllezërit e tij) nuk do të paguante kurrsesi 80 mijë dollarë për të bërë një foto me presidentin e SHBA sikur të mos mendonte se kur ta shohim krah për krah me perandorin do ta ndjekim pas si delet.

As nuk do të bënte intriga tek Porta e Lartë e Washingtonit për të shpallur kryetarin e opozitës non-grata për t’i thënë para popullit: “A e kalon dot ti Atlantikun?” e për ta eliminuar. Jo, jo, jemi ne, që, edhe

kur duam të shpëtojmë nga ajanët, i varim shpresat tek amerikanët, pa është Rama. Mjaft të shikosh opozitën se si po bredh tani nëpër portat e Brukselit për t’u qarë se ajani u ka vjedhur votat në zgjedhjet, apo se si rrimë e komentojmë me pasion deklaratën e Ambasadës amerikane që kësaj here përshëndeti popullin shqiptar për zgjedhjet dhe jo ajanin e radhës, duke shpreuar se mos kanë vendosur ta heqin.

Mirëpo ka një kontradiktë të madhe në pranimin me kënaqësi të kondicionit të vasalit, që disa e kamuflojnë me termin partneritet ose duke i thënë vetes se kësaj here jemi vasalë të perandorisë së të mirës.

Kontradikta qëndron në atë se vasaliteti është bash në kundërshtim me aspiratën tonë për demokraci, liri dhe shtet të së drejtës; për t’u bërë “si gjithë Evropa”, siç kemi aq qejf të themi e siç na premtan ajani ynë i radhës gjithë duke ndërtuar autokraci.

Për të kuptuar këtë kontradiktë mjafton të shtrojmë pyetjen: si ka mundësi që kemi mbi 30 vjet që, me ndihmën e perandorisë së të mirës, në vend se demokracinë, lirinë dhe shtetin e së drejtës kemi ndërtuar shtetin autoritar e kriminal të narko-oligarkëve?

Përgjigja është: sepse nuk kemi mësuar ende dy gjëra që duken sheshit: së pari, se perandorisë së të mirës, siç e tregon edhe marrëveshja Rama- Meloni, por edhe tmerret që po shohim sot në botë, ku ulëret vrasja e mijëra fëmijëve palestinezë me armët e perandorisë, i intereson më shumë vasallëku ynë sesa demokracia jonë.

Së dyti, dhe më kryesorja: sepse demokracia as nuk importohet, as nuk eksportohet, ajo ndërtohet nga popujt që e duan atë. Dhe të duash atë do të thotë të duash të dalësh nga mendësia e vasalitetit.

Dhe dalja nga kjo mendësi është “dalja e njeriut nga gjendja infantile për të cilën ai vetë është fajtor”, siç thotë Kanti kur i përgjigjet pyetjes “ç’është iluminizmi”, që do të thotë nga gjendja e nevojës për tutor, në gjendjen e njeriut që përdor mendjen e vet për të interpretuar botën dhe për të mbrojtur interesat e veta.

NJË VEPËR E VLEFSHME PËR PROCESIN E KRIJIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR DHE PËR ROLIN E SHQIPTARËVE NË RËNIEN E PERANDORISË OSMANE

– Recension për librin e fundit të Daut Dautit, botuar nga shtëpia e njohur botuese, Bloomsbury Academic –

Nga: Andrew Thomas Park, studiues dhe profesor në Universitetin e Hong-Kongut / Revista Journal of British Studies (2024), 1-2, botuar nga Cambridge University Press. Përktheu: Agron Shala /

Libri i Daut Dautit, Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Osmane, 1876-1914 [Britain, the Albanian Question and the Fall of the Ottoman Empire, 1876-1914], gjurmon marrëdhëniet dhe perceptimet e ndërsjella midis elitës politike britanike dhe lëvizjes së sapolindur nacionaliste shqiptare, gjatë katër dekadave që çuan në krijimin e shtetit shqiptar. Nëse për pjesën më të madhe të kësaj periudhe këto marrëdhënie ishin kryesisht të heshtura, për një moment të shkurtër – por, vendimtar, gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1912-'13 – Britania luajti një rol vendimtar. Libri i Dautit ofron një sfond të dobishëm për këto zhvillime, duke u thelluar më herët në kohë sesa studimet e tjera në gjuhën angleze mbi krijimin e shtetit shqiptar dhe duke përdorur burime në gjuhën shqipe dhe nga arkivat ish-osmane.

Në libër, Dauti ndjek kryesisht një strukturë kronologjike. Pavarësisht periudhës së përmendur në titull, kapitulli i parë fillon në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë me përshkrimet e para për Shqipërinë të botuara në Britani – kryesisht nga shkrimtarë udhëpërshkrues, ku më i njohuri ishte poeti Lord Bajron [Byron]. Një tjetër shkrimtar interesant që udhëtoi në rajon ishte Benjamin Disraeli, i cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1830, pak pas rimarjes së kontrollit në vend nga osmanët, duke masakruar qindra krerë shqiptarë që kishin mbështetur grekët në kryengritjen e tyre të mëparshme.

Përshkrimi pozitiv i shqiptarëve nga Bajroni dhe Disraeli bazohet në pikëpamjet e tyre laike, një perspektivë që kundërshtohet nga liberalizmi kristiano-centrik i William Gladstoneit. Qëndrimet britanike ndaj Shqipërisë, argumenton libri, u skalitën kryesisht nga pozicionet konservatore dhe liberale që përfaqësonin Disraeli dhe Gladstone. Megjithatë, kjo nuk solli ndryshime të prekshme në rezultatet politike për shqiptarët.

Kapitulli 2 e ilustron këtë duke vënë në dukje se, pavarësisht qëndrimit të përzemërt të Disraelit gjatë Kongresit të Berlinit më 1878 dhe më pas – sekretari i tij i Jashtëm, Lord Salisbury, u takua me një delegacion të Lidhjes Shqiptare, të trupit të parë (jetëshkurtër) të organizuar të unitetit politik shqiptar – ai në fund “nuk iu përgjigj kërkesës së tyre” (37). Konservatorët i shihnin shqiptarët si një



mburojë mbështetëse të Perandorisë Osmane, ndërsa, për të njëjtën arsye, liberalët i shihnin ata si myslimanë të padenjë për mbështetjen që ata ua jepnin popullsisë të krishtera të Perandorisë Osmane. Kapitulli 3 shqyrton këto perceptime konkurruese teksa vepronin brenda Komitetit Ballkanik – një grup presioni për politikën e jashtme, i themeluar më 1903 dhe që mbështeste autonominë e Maqedonisë Osmane, por që kryesisht e shihte rajonin “përmes prizmit të fesë” dhe për këtë arsye prirje të anashkalonte rolin e shqiptarëve (56).

Shqipëria ishte, sigurisht, gjithmonë pjesë integrale e çështjes maqedonase dhe e fatit më të gjerë të Perandorisë Osmane në Evropë. Kapitujt 4-6 e përshkruajnë këtë dhe kështu nxjerrin në pah edhe rolin e Britanisë në lëvizjen kombëtare shqiptare. Shoqëria Britanike dhe e Huaj Biblike luajti një rol të rëndësishëm që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në përkthimin dhe shpërndarjen e Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, e cila, siç shkruan Dauti, ishte “popullore thjesht sepse ishte një libër në shqip” (88). Britania luajti gjithashtu një rol në planet politike të politikanëve kryengritës shqiptarë. Kur ishte ende besnik ndaj osmanëve dhe jo ende themelues i Shqipërisë moderne, Is-

mail Bej Qemali i dërgoi sulltanit një memorandum në vitin 1892, duke kërkuar një federatë ballkanike dhe një antantë me Britaninë për të zmbrapsur Rusinë.

Në fund, pas Revolucionit të Xhonturqve të vitit 1908, të cilin Dauti e riformulon mirë në lidhje me rolin e rëndësishëm të luajtur nga Shqipëria, qeveria osmane do të orientonte veten drejt Gjermanisë. Ai vëren se si politika e gjuhës shpejt prishi mbështetjen e mëparshme të shqiptarëve me xhonturqit, gjë që përfundimisht çoi në armiqësi të hapur dhe pasoja më të gjera. Megjithatë, çështja e gjuhës ndihet gjithashtu në një mënyrë tjetër. Ndërsa shkrimi i Dautit është kryesisht i qartë, ka disa idiosinkrazi, zgjidhja e të cilave mund të kishte ndihmuar lexuesin.

Ndërsa kryengritja shqiptare e vitit 1911 dështoi, ajo arriti të nxiste Britaninë të mbështeste autonominë shqiptare, gjë që Dauti e përshkruan si “një hap vendimtar në braktisjen, nga qeveria britanike, të politikës miqësore ndaj Portës” (106). Kryengritësit shqiptarë patën më shumë sukses në vitin 1912, por mundësia e autonomisë shqiptare shqetësoi shtetet fqinje ballkanike dhe kjo kontribuoi në shpërthimin e

Luftërave Ballkanike. Lindja e Shqipërisë gjatë Konferencës së Ambasadorëve në vitet 1912-'13, u ndihmua nga Sir Edward Grey, i cili tani e shihte më së miri shërbimin ndaj interesit britanik duke avokuar për një shtet të ri.

Diskutimi i Dautit mbi këtë diplomaci është disi i përmbledhur dhe është më mirë i shpjeguar në librin Lindja e Shqipërisë [The Birth of Albania, 2012] nga Nicola Guy dhe në studimin klasik të Ernst Helmreichut të vitit 1938. Po ashtu, argumenti si i tërë mund të kishte përfituar nga një angazhim më i thellë në kontekstin më të gjerë ndërkombëtar, i cili ndonjëherë humbet për shkak të përqendrimit të ngushtë të Britania. Megjithatë, libri i Dautit nuk është një histori e ngushtë diplomatike, por një përpyetje për të ilustruar lidhjen midis perceptimeve të brendshme britanike dhe rezultateve politike.

Kapitujt 7 dhe 8, dy të fundit të librit, pasqyrojnë këtë, pasi shqyrtojnë karrierat e dy mbështetësve të shquar britanikë të çështjes shqiptare, të cilët ndihmuuan në formësimin e opinionit publik gjatë kësaj periudhe. Edith Durham dhe Aubrey Herbert ishin të dy anëtarë të pakënaqur të Komitetit

të Ballkanit, të cilët u zemëruan nga injorimi i çështjes shqiptare nga ky komitet. Herberti krijoi Komitetin Shqiptar për ta kundërshtuar këtë qëndrim, por ndikimi përfundimtar i përpjekjeve të tij publike është i vështirë për t'u gjykuar. Komiteti kritikoi rezultatin e Konferencës së Londrës, por vetë Herberti lavdëroi Grey.

Duket se Durhami pati më shumë sukses duke ndikuar te diplomatët britanikë – nga terreni në Ballkan. Megjithatë, pasi u largua nga Shqipëria në vitin 1914, ajo u kthye vetëm një herë, shtatë vjet më vonë – dhe mbeti e zhgënjyer, duke shkruar, siç e citon Dauti: “[Nuk] ndjej se Shqipëria ime ekzistonte më” (134). A mund të kishte ekzistuar vërtet ndonjëherë Shqipëria e imagjinuar nga ndonjëri prej britanikëve që trajtohen në këtë libër?

Cilado qoftë përgjigjja për këtë pyetje, në eksplorimin e perceptimeve të brendshme britanike, Dauti ofron një sfond të vlefshëm për procesin e krijimit të shtetit shqiptar, i cili përfundimisht u realizua. Në këtë mënyrë, Dauti gjithashtu arrin të rikthejë rëndësinë e Shqipërisë në historinë e rënies dhe shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

VETON SURROI

SHQIPTARËT NË REVOLUCIONIN TRUMP

A je me ne apo me arushën, pyetje që u bë e vështirë në shekullin XXI I.

Është një dilemë ciklike me të cilën ballafaqohen kosovarët apo edhe shqiptarët në tërësi në momentin kur shtrohet pyetja se a duhet përkrahur një qëndrim politik amerikan apo evropian atëherë kur shfaqen divergjencat, e ato në masë të madhe shfaqen rreth Lindjes së Mesme

Në formën më të butë, kjo dilemë i shfaqet Shqipërisë kur duhet të votojë në OKB (Kosova është e liruar nga kjo dilemë për shkaqe evidente), dhe tashmë prej kohësh Shqipëria mbetet vendi pro-amerikan, edhe kur mbetet në një grup minimal vendesh që janë në përkrahje të Izraelit, një vendi që ushtron gjenocid në Gazë. Kryeministri Rama, me vetëthubim disa herë në konferenca ndërkombëtare konstatoi për këtë lloj besnikërie të këtillë gati si për një pjesë të ADN-së kolektive të vendit: Shqipëria do të jetë vendi më pro-BE edhe po të mos (apo kur të mos) ekzistojë BE-ja.

Në formë më të vrazhdë kjo manifestohet me përkrahje për veprime ushtarake të SHBA-së, siç ishte lufta në Irak. Atëbotë unë isha njëri prej përkrahësve të kësaj ndërhyrjeje - (një përkrahje e gabuar për një ndërhyrje të gabuar) siç u bënë përkrahëse politika në Shqipëri e Kosovë. Për shqiptarët, të çliruar në Kosovë falë ndërhyrjes politike e ushtarake të prirë nga SHBA-ja më 1998 e 1999, ndërhyrja ushtarake amerikane kundër diktatorëve e autokratëve për të çliruar popuj të robëruar ishte krejtësisht e kuptueshme. Arsyet reale (si p.sh. a ka Iraku armë të shkatërrimit në masë), normat ndërkombëtare, vlerësimet gjeopolitike e të tjera ishin dhe ende janë të dorës së dytë për shqiptarët. Në një pjesë të madhe të ligjërimit tonë kemi një obligim moral të qëndrojmë pranë shtetit që na ka çliruar dhe ky është shtytësi ynë kryesor politik. Kështu ndodhi me bombardimin amerikan të Iranit: kryeministrat Kurti dhe Rama - çdonjëri veç e veç dhe në formën e tyre - vunë theksin si çështje parësore qëndrimin shqiptar pro aleatit strategjik e pastaj arsyetimin se bota është më e sigurt nëse një autokraci (a teokraci) si Irani mbetet pa mundësi për armë bërthamore.²

Bombardimi i Iranit nga ana e SHBA-së edhe tashmë si akt i kryer do të nxjerrë dilema morale. Njëra prej tyre është ajo e një pjese të



madhe të vendeve evropiane, të OKB-së e të ekspertizës shkencore se bombardimi nuk ishte legjitim (legal jo se jo sipas së drejtës ndërkombëtare), sepse Irani ka njëzet vjet që dëshmon se nuk ka vënë në funksion procesin e vet bërthamor drejt qëllimeve ushtarake. Këtë në marsin e këtij viti e deklaroi edhe drejtoresha amerikane e inteligjencës, Tulsi Gabbard, konstatim i cili u hodh nga presidenti Trump. Tjetra dilemë është ajo e ligjërimit zyrtar amerikan: nëse nuk kishte (dhe nuk ka) ndërmend të zhvillojë armë bërthamore, çka i nevojitet Iranit uraniami i pasuruar 60 për qind? Pyetje legjitime, ngase uraniami për përdorim civil është pothuajse 20 herë më pak i pasuruar, e kalimi prej 60 për qind në 90 për qind sa nevojitet për armë bërthamore është relativisht i lehtë. Pra, Irani ishte më afër ndërtimit të armës bërthamore sot sesa që ishte para 20 vjetësh.

Por, përtej dilemave morale - për të cilat ligjërimit shqiptar nuk është mjaftueshëm i informuar dhe i përgatitur - bombardimi amerikan i Iranit ka nxjerrë në pah një "truism", siç quhet në anglisht, pra një të vërtetë evidente që më nuk thotë gjë të re. E "truismi" është se në Iran çfarëdo qëndrimi do të merrte Evropa ishte krejtësisht irrellevant. Fuqitë evropiane dhe BE-ja u përpoqën deri në moment të fundit të mbanin të hapur tryezën negociatore - siç kishin prirë në procesin e Marrëveshjes më 2015, por presi-

denti Trump shpërfilli tërë këtë angazhim.

"Truismi" rrjedh prej veprimeve të mëhershme të administratës Trump, që nga vendosja e tarifave ndaj shteteve partnere, shpërfaqja për aneksim të Grenlandës e deri te një krizë tjetër, ajo e luftës së Ruisë kundër Ukrainës. Aty, pa kurrfarë konsultimi me Evropën - e cila edhe po të mos ishte formalisht pjesë e Aleancës Transatlantike është hapësira në të cilën zhvillohet lufta - SHBA udhëhoqi negociatën, deri tani të pasuksesshme, për të realizuar një premtim të atëherë kandidatit Trump, se do ta përfundonte luftën brenda një dite.

Veprimet e presidentit Trump, rrjedhimisht, nuk janë përjashtim i përkohshëm nga politika e zakonshme amerikane, por janë rregull i ri - ai i "rikthimit të sovranitetit amerikan", siç quhej në fushatë pjesa e këtij revolucion që po ndodh në marrëdhëniet mes SHBA-së dhe botës. Ndonëse SHBA-së nuk i ka munguar ndonjëherë sovraniteti, "rikthimi i sovranitetit amerikan" në revolucionin Trump do të thotë shkëputje prej botës së deritanishme, të ndërtuar në masë të madhe me udhëheqje amerikane nga viti 1945 e këtej, në të cilën janë ndërtuar aleanca e institucione.

Në vend të tyre "sovranizmi" amerikan është e drejta për veprime unilaterale, të mbështetura në forcë, pa nevojë konsultimi me kë; një

Amerikë që nuk konsultohet e bashkëvepron me institucionet dhe aleancat ndërkombëtare të cilat i ka ndërtuar si një vizion i shumëfishimit të forcës së vet e të forcës së modelit të demokracisë liberale.

3.

Në mendjen e shqiptarëve, atëherë, përkrahja automatike ndaj veprimeve të presidentit Trump ka të bëjë edhe me njohjen e këtij realiteti të ri, në të cilin administrata amerikane mund të tërheqë veprime të papritura.

Kjo nuk paraqet ndonjë rrezik për Shqipërinë, e cila ka apo ka krijuar mbrojtje të dyfishtë. Ajo nga njëra anë nuk është pjesë e krizave të luftërave të ish-Jugosllavisë dhe për dallim prej Kosovës nuk përbën pikë tërheqëse për ndërhyje eventuale të administratës Trump.

Nga ana tjetër, kryeministri Rama vendosi që në vend të dhënies së ishullit Sazan për zhvillim turistik ndonjërit prej ndërmarrësve të favorizuar shqiptarë këtë t'ia bënte një pjese të familjes Trump - pra një investimi të madh sa amerikan aq edhe i lidhur me familjen e presidentit.

Shqiptarët, vështrues të ngjarjeve nga margjina evropiane, kanë vërejtur diçka që popujt e tjerë evropianë tashmë e kanë shndërruar në bindje. Në sondazhin e fundit të realizuar nga ECFR (Këshilli Evropian për Marrëdhënie të Jashtme) me 16 mijë të anketuar,

njëri prej konstatimeve thelbësore është se qytetarët tash po e shndërron BE-në nga një projekt të paqes në projekt të luftës. Pra, lufta e Ruisë kundër Ukrainës dhe sjellja e presidentit Trump ndaj kësaj lufte kanë bërë që qytetarët e BE-së të kuptojnë nga njëra anë se SHBA-ja nuk është më garantuesi i paqes në kontinentin evropian dhe se tash shtetet e tyre duhet të marrin përsipër edhe dimensionin e sigurisë evropiane.

Dyzet vjet pas Luftës së Dytë Botërore në institucionin më të lartë të një pjese të madhe të kontinentit evropian ekziston komisionari për mbrojtje. Ky është njëri realitet i veprimit të "revolucionit Trump", të cilin evropianët e anketuar e shohin si strukturor. Pra në shumicë, evropianët (me përjashtim të rumunëve dhe hungarezëve) e shohin problemin jo vetëm te Trumpi, të cilin e perceptojnë si të dëmshëm për shoqërinë amerikane dhe shoqëritë e tyre, por shprehin mospbesim ndaj sistemit politik amerikan në tërësi.

E, megjithatë, evropianët e tjerë (ata të anketuarit) nuk janë larg shqiptarëve. Shumica e respondentëve nuk besojnë se Evropa do të ketë së shpejti "autonomi strategjike", pra fuqi unike ushtarake mbrojtëse. Shumica e respondentëve mendojnë se duhet përkrahur Ukrainën që ta mbrojë Evropën prej Ruisë. Dhe shumica e respondentëve mendojnë se politika amerikane mund të ndryshojë pas mandatit të presidentit Trump.

Në mënyrë instinktive, evropianët e tjerë u afrohen shqiptarëve, si vështrues, ndonëse aktivë, por megjithatë në margjinë të ngjarjeve.

4.

Në traditën shqiptare të Kosovës ka mbetur një pyetje, prej një barsolete: "a je me ne, a me arushën?". Në shekullin XXI kjo pyetje, që duhet të nënkuptojë zgjedhjen binare, është bërë shumë më e ndërlikuar se ndonjë herë tjetër. Jo ndoshta me pyetjen për "arushën", por për përcaktimin e asaj kush jemi "ne". Në fillim të këtij shekulli, "ne" nënkuptonte instinktivisht Perëndimin. Por Perëndimi, si koncept politik nuk ekziston, së paku jo i atillë çfarë e kemi njohur atëherë kur e çliroi Kosovën dhe kur e ndihmoi të pavarësohej.

Dhe, në këtë rizbulim shqiptarët janë bashkë me evropianët e tjerë.

**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas



07774222062



07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

